

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5787
E hënë, 27 maj 2019
çmimi 0.40 €

Veseli: Të luftohet korrupsioni

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

**A DUHET QEVERIA E
KOSOVËS TA NJOHË
ZYRTARISHT HAPËSIRËN
KIBERNETIKE SI NJË KUFI
TË EDUKIMIT DHE TË
MBROJTJES KOMBËTARE** F.11

Rahmil LIMANI

AKTUALE

**PËRURORHEN PLLAKAT 'BAZË E
UÇK'-SË NË SHITËPITË E
HASAN TAHIRIT DHE IDRIZ
NURAKUT NË PLLUZHINË** F. 6



**ZGJIDHET PROBLEMI
I BANORËVE TË FSHATIT
DOGANAJ PËR RRUGËN** F. 6

EKONOMI

**DUKURIA E RREZIKSHME
E FAJDEVE** F. 8

**KRYETARËT E ODAVE
EKONOMIKE TË BALLKANIT
PERËNDIMOR, IDE
KONKRETE PËR AVANCIMIN
E BASHKËPUNIMIT
RAJONAL** F. 9

SPORT

**LLUMNICA DHE SERMAXHAJ:
SUKSESET E 'NIKLIT',
TË MERITUARA** F. 16



FLET PËR "EPOKËN E RE", REXHEP SELIMI

FAQE 4-5

Rrëzimi i qeverisë, pika e përbashkët e LV-së dhe LDK-së

- Nuk llogarisim në votat
e Listës Serbe për
rrëzimin e qeverisë

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga
radhët e Lëvizjes Vetëvendosje (LV),
Rexhep Selimi, ka thënë se bashkëpunimi
opozitar në mes të kësaj partie dhe
Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK)
është mjaft i natyrshëm. Ai ka theksuar
se, pavarësisht prej dallimeve, pika e

përbashkët e këtyre dy subjekteve është
rrëzimi i qeverisë. Në këtë intervistë
dhënë për gazetën "Epoka e re", Selimi
ka deklaruar se vetëm zgjedhjet e
parandalojnë kolapsin e vendit. Ai ka
treguar se nuk llogarisin në votat e
Listës Serbe për ta rrëzuar qeverinë por,

sipas Selimit, mocioni do të bëhet kur
të koordinohen me deputetët që e duan
rrëzimin e kësaj qeverie. Sa i përket
qeverisjes së deritanishme, ai ka thënë
se është përshkuar me veprime
populiste, keqqeverisje, korrupsion,
nepotizëm dhe paaftësi

Bëhet thirrje që partitë politike të bashkohen për tribunalin

FAQE 3

Profesorët universitarë nga fusha e
marrëdhënieve ndërkombëtare dhe e
drejtësisë i kanë ftuar partitë politike që
të bashkohen për themelimin e tribunalit
ndërkombëtar për krimet serbe në

Kosovë. Ata kanë deklaruar për gazetën
"Epoka e re" se zbardhja dhe dënimi i
krimeve serbe në Kosovë është
përgjegjësi e të gjithëve dhe se askush
nuk ka të drejtë ta kundërshtojë këtë



iniciativë. Ibrahim Gashi, Sabri Kiçmari
dhe Ismet Salihi kanë treguar se nëpërmjet
mbledhjes së provave si dhe lobimit të
shtetet dhe organizatat e fuqishme e
bëjnë realitet themelimin e këtij tribunalit



Thaçi: Nëse BE-ja na i mbyllë dyert, bashkimi kombëtar bëhet realitet

FAQE 5

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Pendarovski: Pres nga Turqia ratifikimin e protokollit për NATO-n

SHKUP, 26 MAJ - Pres që Republika e Turqisë të konfirmojë mbështetjen për Republikën e Maqedonisë së Veriut në rrugën e saj Euro-Atlantike nëpërmjet ratifikimit të Protokollit të Anëtarësimit në NATO, porositi kreut i shtetit Stevo Pendarovski, në fjalimin që mbajti për darkën e iftarit në Universitetin Ndërkombëtar Ballkanik Shkup, organizuar nga Ambasada e Republikës së Turqisë.

Siç ka njoftuar kabineti i Pendarovskit, në praninë e kryetarit të Asamblesë së Madhe Kombëtare të Republikës së

Turqisë, Mustafa Shentop, Pendarovski theksoi se që nga fillimi i pavarësisë sonë, Republika e Turqisë ka mbështetur Republikën e Maqedonisë së Veriut në rrugën e saj evropiane dhe euroatlantike, ka njoftuar Alsat-M.

Ndonjëherë mund të kemi pasur edhe pikëpamje të ndryshme për disa çështje, por gjithmonë mund të arrih të gjes zgjidhje më të pranueshme për të dyja palët. Prandaj, si president pres që miqtë tanë turq ta konfirmojnë këtë mbështetje duke ratifikuar

protokollin për anëtarësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO. Sepse anëtarësimi ynë në Aleancë nuk nënkupton vetëm potencialin tonë ushtarak, por edhe vlerat tona të bashkëjetesës dhe të respektit të diversitetit", tha presidenti Pendarovski.

Prioritet i tij, siç thuhet në njoftim, është të kontribuojë në pajtimin civil.

"Qëllimi im është që në shtetin tonë evropian të promovoj vlerat të cilat afrojnë dhe jo vlera që ndajnë", tha Pendarovski.



Maqedonia e Veriut pret datën për nisjen e bisedimeve me BE-në

Meqë janë arritur rezultate të pamohueshme në konsolidimin e institucioneve, sundimin e ligjeve dhe sferat tjera ku ka pasur vërejtje në raportet e kaluara, Maqedonia e Veriut pret vlerësim pozitiv nga raporti i progresit i Komisionit Evropian që pritet të publikohet më 29 maj, ndërsa në qershor shpreson edhe për marrjen e datës për fillimin e bisedimeve për anëtarësim në union

SHKUP, 26 MAJ - Maqedonia e Veriut pret vlerësim pozitiv nga raporti i progresit i Komisionit Evropian që pritet të publikohet më 29 maj, ndërsa në qershor shpreson edhe për marrjen e datës për fillimin e bisedimeve për anëtarësim në union.

Nga Qeveria thonë se vendi ka arritur rezultate të pamohueshme në konsolidimin e institucioneve, sundimin e ligjeve dhe sferat tjera ku ka pasur vërejtje në raportet e kaluara.

Së fundi janë miratuar ligjet për reformimin e agjencive të sigurisë dhe të punëve të brendshme, ndërsa ka mbetur ende zvarrë çështja e statusit të Prokurorisë Speciale që po heton zyrtarët e dyshuar për vepra penale.

Zëvendëskryeministri për çështje evropiane, Bujar Osmani, thotë se administrata është e përqendruar në përmbushjen e të gjitha detyrimeve që dalin në procesin

e integritimit evropian.

"Në pritje të vendimit të madh për nisjen e bisedimeve, në pritje në fakt të Raportit të Komisionit për Progresin në vitin e kaluar, po intensifikojmë aktivitetet tona për të përgatitur administratën për ballafaqim me këtë sfidë të madhe, në të cilin pritet të futet vendi. Sekretariati për çështje evropiane do të mbetet mekanizmi kryesor i administratës që do të fokusohet në krijimin e kapaciteteve njerëzore, që është sfida më e madhe, por edhe pika më e dobët dhe më e fuqishme, varësisht institucioneve në përpjekje për të arritur standardet evropiane", deklaroi Osmani, ka njoftuar rfe.

Edhe ambasadori i Bashkimit Evropian, Samuel Zhbogar, pret që në javën e ardhshme Komisioni Evropian të publikojë raport pozitiv për Maqedoninë e Veriut, apo do të rekomandojë caktimin e datës për hapjen e



negociatave për anëtarësim.

Ai thotë se raporti do të pasqyrojë përparimin në raportet me shtet fqinj, përfshirë Maqedoninë e Veriut.

"Jam i bindur se raporti do të rekomandojë hapjen e bisedimeve me Maqedoninë e Veriut. Mendoj se vendi juaj muajt e fundit ka demonstruar përkushtim për të ardhmen evropiane, pasi janë sjellë vendime të rëndësishme. Opozita dhe Qeveria po punojnë bashkërisht

në disa ligje që janë të rëndësishme për reformat dhe mendoj se keni shumëçka për të treguar dhe shpresoj se ju do të jeni shembull në rajon për atë se si mund të demonstron përkushtimi serioz në çuarjen para të vendit", ka deklaruar ambasadori i BE-së, Samuel Zhbogar.

Njohësit e çështjeve ndërkombëtare thonë se raporti i Komisionit Evropian do të përmbajë edhe kritika, në veçanti në

sferën e sundimit të drejtës. Muhamed Halili, ish-ambasador, thotë se Komisioni mund të rekomandojë hapjen e negociatave, por se në samitin e krerëve të shteteve dhe të Qeverisë një rekomandim i tillë nuk beson se do të miratohet.

"Konsideroj se raporti do të ketë vërejtje, veçanërisht vërejtje për sundimin e ligjit dhe së drejtës, ndërsa vendimi përfundimtar është vendim politik që merret në samitin e burrave të shteteve dhe qeverive që do të mbahet pasi Komisioni Evropian të ketë dhënë vlerësimin e vet. Nëse Maqedonia nuk i ka plotësuar kërkesat, para së gjithash në reformimin e Gjyqësorit, e që tani paketat e fundit është mbyllur përveç Prokurorisë Speciale, mund të ndodhë që në samitin evropian të silltet vendim, por si qëndrojnë punët tani vlerësoj se në këtë sesion është pamundur të merret data", thotë Halili.

Procesi i integritimit apo i marrjes së datës për anëtarësim në BE, në vazhdimësi ishte bllokuar nga Greqia për shkak të çështjes së emrit, por pas zgjidhjes së këtij kontesti, Maqedonia e Veriut të paktën nga Athina nuk do të kushtëzohet më në procesin e integritimit evropian. Statusin e shtetit kandidat Maqedonia e Veriut e ka marrë në vitin 2005.

Basha: Ne jemi populli i Evropës, asnjë hap pas

TITANË, 26 MAJ - Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha tha një ditë pas protestës në kryeqytet se "forca jonë është bashkimi, forca jonë është qendra, forca jonë është përballja deri në fitoren e kësaj beteje për Shqipërinë si gjithë Evropa".

"Asnjë hap pas", tha ai, në një

reagim pas protestës së 25 majit.

"Ne jemi populli i Evropës, ne jemi populli i Lirisë, ne jemi populli i demokracisë. Ne jemi njerëz që besojmë në vlera, besojmë te dinjiteti i njeriut, besojmë te familja, besojmë tek atdheu", tha Basha.

"Demokracinë nuk e japim, të drejtat dhe liritë tona nuk i dorëzojmë. Beteja për to është misioni më i madh dhe më fisnik i njeriut të lirë. Beteja me të keqen, po e çliron dhe fisnikëron shoqërisë dhe kombit tonë", tha kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha.



Mundësinë e themelimit të tribunalit ndërkombëtar për krimet serbe në Kosovë nuk duhet ta kundërshtojë askush, thonë disa profesorë universitarë

Bëhet thirrje që partitë politike të bashkohen për tribunalin

Profesorët universitarë nga fusha e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe e drejtësisë i kanë ftuar partitë politike që të bashkohen për themelimin e tribunalit ndërkombëtar për krimet serbe në Kosovë. Ata kanë deklaruar për gazetën "Epoka e re" se zbardhja dhe dënimi i krimeve serbe në Kosovë është përgjegjësi e të gjithëve dhe se askush nuk ka të drejtë ta kundërshtojë këtë iniciativë. Ibrahim Gashi, Sabri Kiçmari dhe Ismet Salihu kanë treguar se nëpërmjet mbledhjes së provave si dhe lobimit të shtetit dhe organizatave të fuqishme e bëjnë realitet themelimin e këtij tribunalin

institucionet e Kosovës mos të punojnë për krijimin e dëshmimeve se: Serbia në Kosovë ka kryer krime të gjenocidit, se kriminelët jo vetëm se shëtiten të lirë, por drejtuesit e shtetit serb jo vetëm se nuk janë penduar e kërkuar falje për këtë, por ata kërkojnë edhe t'i mohojnë krimet e gjenocidit. Pra, ka shumë arsye që faktori politik shqiptar, pozitiv-opozitiv, për këto çështje duhet të jetë i bashkuar", ka thënë Krasniqi për gazetën "Epoka e re".

punojnë për dënimin e këtyre krimeve. Nëse presim vetë themelimin e një gjykate ndërkombëtare për dënimin e këtyre krimeve nuk mund të bëhet ndonjë gjë e madhe. Themelimi i kësaj gjykate do të jetë sfiduese, sensitive, e ndjeshme dhe komplekse por, nuk përjashtohet. Nëse ne punojmë, mbledhim fakte dhe ato ua prezantojmë kancelarive të Evropës dhe botës, atëherë mund të krijohet baza apo platforma e themelimit të kësaj gjykate", ka thënë Salihu.

shumë punë për arritjen e këtij qëllimi. "Një lobim i mirë pranë shteteve dhe organizatave ndërkombëtare me ndikim do të mund të ndihmonte në sensibilizimin e nevojës për ngritjen e një tribunalin të tillë", ka thënë ai, duke shtuar se edhe gjykatat vendore, duke i dënuar kriminelët serbë në mungesë, do ta sensibilizonin opinionin ndërkombëtar për krijimin e një tribunalin të tillë. "Ndoshta dëshmitarët dhe gjykatat vendore, duke zbuluar dhe ngritur padi për kriminelët, oftojnë edhe në mungesë (sepse një pjesë e madhe e kriminelëve potencialë serbë janë të lirë dhe gjenden në Serbi, madje edhe në institucione atje) do ta sensibilizonte drejtësinë ndërkombëtare për nevojën e ngritjes së një tribunalin të tillë", është shprehur Gashi për gazetën "Epoka e re".

Me votat e të gjitha partive shqiptare, Kuvendi i Kosovës ka miratuar një rezolutë për gjenocidin serb në Kosovë. Por, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje e kanë braktisur seancën parlamentare në të cilën flitej për formimin e komisionit shtetëror, i cili do të mbledhte fakte dhe prova për krijimin e një tribunalin për gjenocidin serb në Kosovë. Është paralajmëruar se ky komision i iniciuar nga kryeparlamentari Kadri Veseli do të votohet në seancat e ardhshme parlamentare.

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 26 MAJ - Njohësit e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe profesorët universitarë i kanë bërë thirrje spektrit politik që të bashkohen rreth iniciativës për themelimin e një tribunalin ndërkombëtar për krimet serbe në Kosovë. Ata kanë thënë se nisma për të ndriçuar dhe kërkuar llogari për krimet serbe të kryera në Kosovë është e qëlluar, ndonëse e vonuar. Sipas tyre, dënimi i gjenocidit serb në Kosovë është përgjegjësi e gjithë spektrit politik, pozitiv dhe opozitiv.

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, shpreson se refuzimi i LDK-së dhe LV-së për themelimin e këtij tribunalin të jetë i përkohshëm. "E kam thënë edhe një herë që për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shtetndërtimin, përgjegjësia është e të gjithë përfaqësuesve të popullit, pavarësisht janë në pushtet apo në opozitë. Nuk dua të besoj se në të ardhmen ndonjë subjekt politik shqiptar apo politikan individualisht nuk do ta mbështeste idenë e krijimit të këtij tribunalin. Shpresoj se është refuzim i përkohshëm", ka thënë Gashi për "Epokën e re".

Edhe ish-ambasadori i Kosovës në Austri dhe Australi, Sabri Kiçmari, i ka dhënë mbështetje iniciativës për themelimin e një gjykate ndërkombëtare për krimet serbe në Kosovë. "Është një iniciativë e vonuar, por që duhet mbështetur. Në fakt, Kosova ka dështuar në trajtimin me seriozitet dhe kompetencë për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë. Kam përshtypjen se është neglizhuar një gjë e tillë. Ata që kanë udhëhequr sistemin tonë të drejtësisë janë përgjegjësit kryesorë që nuk është bërë një gjë e tillë. Trajtimi i krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë

është një obligim. Ata që kanë kryer krime duhet të identifiko-hen, arrestohen, gjykojnë dhe dënohen", ka thënë Kiçmari. Ndërsa ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, ka bërë me dije se askujt prej partive politike nuk i takon që të deklarohet se mund apo nuk mund të themelohet tribunalin ndërkombëtar për krimet serbe në Kosovë. Ai i ka ftuar institucionet e Kosovës që të punojnë në këtë drejtim. "Ne konsiderojmë se asnjë parti politike veç e veç, as marrë së bashku, nuk i takon të deklarohet mund apo nuk mund të bëhet një gjykatë që do të merret me dënimin e krimeve të gjenocidit serb. Është e vërtetë se Kosova ka pak mundësi për të ndikuar në themelimin e kësaj gjykate për dënimin e krimet të gjenocidit të kryer në Kosovë gjatë vitit 1998/99, por kjo nuk do të thotë se ka ndonjë alibi, që

Si mund të bëhet tribunalin?

Profesorët e të drejtës penale dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare kanë treguar se si Kosova mund të arrijë deri te tribunalin për krimet serbe në Kosovë. Sipas tyre, institucionet e Kosovës duhet të mbledhin fakte për këto krime dhe të llojnë nëpër kancelaritë e fuqishme evropiane dhe botërore. Profesori i së drejtës penale ndërkombëtare, Ismet Salihu, ka treguar për gazetën "Epoka e re" se edhe gjykatat vendore duhet të ngrehin aktakuza për krimet serbe. "Mbledhja e fakteve nga rithemelimi i institutit dhe puna e institucioneve të drejtësisë duhet të na çojë kah themelimi i një gjykate penale ndërkombëtare. Natyrisht se në këtë drejtim duhet të punojnë edhe gjykatat tona, duhet të



Flet për "Epokën e re", Rexhep Selimi

Rrëzimi i qeverisë, pika e pë

- Nuk llogarisim në votat e Listës Serbe për rrëzimin e qeverisë



Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Rexhep Selimi, ka thënë se bashkëpunimi opozitar në mes të kësaj partie dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) është mjaft i natyrshëm. Ai ka theksuar se, pavarësisht prej dallimeve, pika e përbashkët e këtyre dy subjekteve është rrëzimi i qeverisë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Selimi ka deklaruar se vetëm zgjedhjet e parandalojnë kolapsin e vendit. Ai ka treguar se nuk llogarisin në votat e Listës Serbe për ta rrëzuar qeverinë por, sipas Selimit, mocioni do të bëhet kur të koordinohen me deputetët që e duan rrëzimin e kësaj qeverie. Sa i përket qeverisjes së deritanishme, ai ka thënë se është përshkuar me veprime populiste, keqqeverisje, korrupsion, nepotizëm dhe paaftësi

më të mëdha opozitare, rrjedhimisht edhe parlamentare, dhe bashkëpunimin nuk e pengon e kaluar oponente në mes të këtyre dy subjekteve. Me gjithë bashkëpunimin e deritanishëm opozitar, jemi subjekte të ndryshme ku dallimet, sado qofshin të mëdha, nuk na ndajnë në qëndrimet tona për qeverisjen aktuale", ka deklaruar ai.

Selimi ka thënë se vetëm zgjedhjet e parandalojnë kolapsin e vendit, por ai ka treguar se nuk llogarisin në votat e Listës Serbe për ta rrëzuar qeverinë. "Ka kohë që, përveçse opozita nuk i ka numrat e mjaftueshëm për rrëzimin e qeverisë, as qeveria nuk e ka mazhorancën. Në mes të palëve gjendet Lista Serbe me të cilën ne nuk bashkëpunojmë, nuk ia kërkojmë votat e as nuk llogarisim në votat e saj për rrëzimin e qeverisë, ashtu siç as nuk mund t'ia imponojmë se si do të silllet dhe si do të votojë në

Kuvend në rast mocioni për rrëzimin e qeverisë. Kurdo që koordinohemi me deputetët që e duan rrëzimin e qeverisë ne do të shkojmë drejt mocionit", ka theksuar Selimi.

Në këtë intervistë ai ka folur edhe për qeverisjen e deritanishme duke thënë se është përshkuar me veprime populiste, keqqeverisje, korrupsion, nepotizëm dhe paaftësi. Kurse për negociatat me Serbinë, deputeti Selimi ka thënë se është një proces antishqiptar, antikushetues dhe antishqiptar. "Qeveria e koalicionit PAN është një qeveri e dështuar qysh në ditën e parë. Përveç disa veprimeve populiste, shumëçka tjetër ka të bëjë me keqqeverisje, korrupsion, nepotizëm dhe paaftësi në drejtim. Lëvizja Vetëvendosje është konsistente në qëndrime, po ashtu edhe në qëndrimet e saj për negociatat dhe dialogun me Serbinë. Procesi i negociatave

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 26 MAJ - Deputeti i Kuvendit të Kosovës, Rexhep Selimi, ka thënë të dielën se, pavarësisht prej dallimeve, pika e përbashkët e Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) është rrëzimi i qeverisë. Në këtë

intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai e ka quajtur të natyrshëm bashkëpunimin ndërmjet këtyre dy subjekteve. "Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës janë subjekte parlamentare opozitare dhe bashkëpunimi opozitar është mjaft i natyrshëm. Me gjithë dallimet që i kemi si subjekte të ndara politike, rrëzimi i

qeverisë është pikë jonë e përbashkët", është shprehur Selimi, duke shtuar se ky bashkëpunim po pritët me optimizëm nga qytetarët si mënyra më e lehtë për t'u çliruar nga qeverisja e tanishme. "Ne nuk jemi të përqendruar në të kaluarën në mes të LV-së dhe LDK-së kur ishim në raporte oponente në Kuvend. Tani jemi dy subjektet

r bashkët e LV-së dhe LDK-së

Haradinaj, kur kjo qeveri prej atëherë e deri më sot nuk ia ka arritur ta manifestojë shumicën parlamentare në Kuvend. Prandaj, kur një qeveri nuk e ka shumicën parlamentare, kur në Kuvend tashmë ka ndryshuar raporti politik, kur në Kuvend nuk mund të votohen nga mazhoranca as ligjet me shumicë të thjeshtë, kur skandalet janë përditshmëri serike e qeverisë dhe, në anën tjetër, kur pakënaqësia e qytetarëve vjen duke u rritur përditë, atëherë vetëm zgjedhjet duhet të ndodhnin para se të shkojë vendi në kolaps. Në këtë situatë Lëvizja Vetëvendosje është e angazhuar që në mundësinë e parë të shkojmë drejt zgjedhjeve të parakohshme qoftë me mocion mosbesimi, qoftë me dorëheqje të qeverisë. Mbështetur në këtë qëndrim, Lëvizja Vetëvendosje angazhohet që opozita t'i mbledhë votat e mjaftueshme për mocionin për rrëzimin e qeverisë.

Ka kohë që, përveç që opozita nuk i ka numrat e mjaftueshëm për rrëzimin e qeverisë, as qeveria nuk e ka mazhorancën. Në mes të palëve gjendet Lista Serbe me të cilën ne nuk bashkëpunojmë, nuk ia kërkojmë votat e as nuk llogarisim në votat e saj për rrëzimin e qeverisë ashtu siç nuk mund t'ia imponojmë se si do të sillet dhe si do të votojë në Kuvend në rast mocioni për rrëzimin e qeverisë. Kurdo që koordinohemi me deputetët që e duan rrëzimin e qeverisë ne do të shkojmë drejt mocionit.

"Epoka e re": Për shkak të së kaluarës dhe kundërshtimeve që kanë pasur këto dy parti po shihet me skepticizëm kjo iniciativë në opinionin publik dhe nga analistët.

Selimi: Ne nuk jemi të përqendruar në të kaluarën në mes të LV-së dhe LDK-së kur ishim në raporte oponente në Kuvend. Tani jemi dy subjektet më të mëdha opozitare, rrjedhimisht edhe parlamentare, dhe bashkëpunimin nuk e pengon e kaluara oponente në mes të këtyre dy subjekteve. Ky bashkëpunim nuk shihet me skepticizëm nga qytetarët, përkundrazi pritjet me optimizëm si mënyrë më e lehtë për t'u çliruar nga qeverisja e tanishme. Me gjithë bashkëpunimin e deritanishëm opozitar ne jemi subjekte të ndryshme ku dallimet, sado qofshin të mëdha, nuk na ndajnë në qëndrimet tona për qeverisjen aktuale.

"Epoka e re": Cila është formula për sigurimin e 61 votave meqë PSD-ja thotë se nuk pranon që t'i japë votat e saj që, bashkë me Listën Serbe, ta largojnë PAN-in

nga pushteti? Keni besim se mund të siguronin ndonjë votë brenda koalicionit qeverisës?

Selimi: Bashkëpunim me Listën Serbe ka vetëm koalicioni PAN i cili, përmes votave të këtij subjekti fashist (LS), e kanë krijuar shumicën për formimin e qeverisë Haradinaj. Pra, Lista Serbe e përcaktoi shumicën për formimin e qeverisë duke u bërë determinuese jo vetëm për themelimin e qeverisë, por shpeshherë edhe për funksionimin e institucioneve të Republikës. Në ndërkohë, për mbajtjen në këmbë të kësaj qeverie kontribuoi edhe grupi parlamentar i PSD-së duke ia krijuar shumicën qeverisë, sidomos për ligjin me të rëndësishëm, siç është Ligji i Buxhetit dhe për votimin e ekipit parlamentar i PSD-së Listën

Serbe dëshiron ta përjashtojë nga roli i saj përcaktues dhe atë rol ta marrë duke qëndruar në mes të pushtetit dhe opozitës, gjithnjë në favor të qeverisë të cilën shpeshherë edhe e kushtëzojnë në këmbim të votave të tyre. Sa i përket asaj se a i besoj unë personalisht grupit parlamentar të PSD-së apo jo, tregojnë veprimet e tyre në të kaluarën e afërt.

"Epoka e re": Z. Selimi, çfarë vlerësimi keni për qeverisjen e deritanishme të koalicionit qeverisës?

Selimi: Qeveria e koalicionit PAN është një qeveri e dështuar qysh në ditën e parë. Përveç disa veprimeve populiste, shumëçka tjetër ka të bëjë me keq-qeverisje, korrupsion, nepotizëm dhe paaftësi në drejtim.

"Epoka e re": Ka ndryshuar qëndrim Lëvizja Vetëvendosje sa i përket procesit të dialogut me Serbinë?

Selimi: Lëvizja Vetëvendosje është konsistente në qëndrime, po ashtu edhe për negociatat dhe dialogun me Serbinë. Procesi i negociatave me Serbinë është një proces antishtetëror, antikushtetues dhe në thelb, antishqiptar. Vetë planet e fshehta të Thaçit dhe të Vuçiqit e tregojnë se ata kanë plane të këqija për Kosovën dhe për shqiptarët në favor të Serbisë. Prandaj, i kemi kundërshtuar në vazhdimësi dhe do t'i kundërshtojmë derisa ta largojmë rrezikun që na kanoset nga këto planë të fshehta e djallëzore të Thaçit e Vuçiqit, apo edhe të kujtdo që është prapa tyre.

Thaçi: Nëse BE-ja na i mbyllë dyert, bashkimi kombëtar bëhet realitet

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka paralajmëruar BE-në se nëse vazhdon t'i mbyllë dyert për Shqipërinë dhe Kosovën bashkimi kombëtar mund të bëhet realitet. Ai ka vlerësuar se ky mision nuk është i pamundur dhe se bashkimi kombëtar është në mendjen dhe shpirtin e çdo shqiptari

"Epoka e re"

PRISHTINË, 26 MAJ - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije se Kosova dhe Shqipëria mund të bëhen bashkë nëse Bashkimi Evropian vazhdon t'i mbyllë dyert e saj për shqiptarët. Duke reaguar ndaj kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, i cili ka kërkuar që Thaçi të heqë dorë nga ideja e tij për korrigjimin e kufirit, i pari i vendit i ka kërkuar liderit të LDK-së që ta mbështesë idenë e tij. "Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, nëpërmjet një postimi më paska dhënë disa këshilla. Duke e falënderuar atë për këtë përpjekje, ritheksoj se asnjë e keqe nuk i vjen vendit nga debati dhe paraqitja e pikëpamjeve të ndryshme për realizimin e qëllimit të përbashkët. Korrigjimi i padrejtësive ndaj Luginës së Preshevës dhe shqiptarëve është përkushtimi im i pandalshëm. Lugina e Preshevës duhet të bashkohet me Kosovën, njësoj sikurse Kosova që duhet të bashkohet natyrshëm me Shqipërinë, nën ombrellën e përbashkët të BE-së ose edhe vetëm nën ombrellën shqiptare, nëse BE-ja vazhdon t'i mbyllë dyert e saj për ne", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në



"Facebook".

Ai ka shkruar se këshillat e të tjerëve vetëm e bëjnë më të fortë drejt arritjes së qëllimit të tij përfundimtar. "Ju z. Mustafa dhe shumë të tjerë mund të më këshilloni. Kjo më bën më të fortë në punën time drejt qëllimit final. Ndoshta ju mendoni se unë jam i vetëm sot në këtë mision, i cili për ju dhe disa të tjerë duket i pamundur. Por, mos të harrojmë se vetëm 20 vjet më parë edhe liria dhe pavarësia jonë janë dukur të pamundura. Në përpjekje për arritjen e këtij qëllimi, unë kërkoj miq dhe aleatë. Unë dua që ju z. Mustafa të jeni në krah me mua. Të tjerët që hezitojnë sot duhet ta mendojnë mirë këtë çështje, por mos të vonohen shumë. Nuk është mision i pamundur, përkundrazi. Bashkimi kombëtar është

në mendjen dhe shpirtin e çdo shqiptari. Le ta bëjmë realitet bashkë", ka vlerësuar Thaçi. Ndërsa lideri i LDK-së, Isa Mustafa, në një adresim të tij përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ku kishte kërkuar të ndalen sulmet ndërmjet presidentit Hashim Thaçi dhe ish-presidentit të Shqipërisë, Salih Berisha, ka vlerësuar se ideja për korrigjimin të kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë është e dëmshme. "Presidentit Thaçi ia kam thënë edhe personalisht dhe e ka thënë gati tërë Kosova, publikisht, se diskursi i tij politik për korrigjimin të kufijve është shumë i gabueshëm dhe i papranueshëm. Ai duhet të korrigjohet. Nëse jo, do ta ketë veten në qafë, jo të tjerët", ka thënë Mustafa.

me Serbinë është një proces antishtetëror, antikushtetues dhe në thelb edhe antishqiptar", ka thënë Selimi.

"Epoka e re": Z. Selimi, tashmë Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) kanë filluar bashkëpunimin për rrëzimin e qeverisë. Si e shihni këtë iniciativë dhe sa mund të ketë sukses?

Selimi: Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës janë subjekte parlamentare opozitare dhe bashkëpunimi opozitar është mjaft i natyrshëm. Pika e përbashkët për LV-në dhe për LDK-në është që kjo qeveri duhet të dorëhiqet ose të rrëzohet. Me gjithë dallimet që i kemi si subjekte të ndara politike, rrëzimi i qeverisë është pikë jonë e përbashkët. Rrethanat për të pasur zgjedhje të parakohshme në Kosovë janë krijuar qysh në ditën e parë të qeverisë

Përrurohen pllakat 'Bazë e UÇK'-së në shtëpitë e Hasan Tahirit dhe Idriz Nurakut në Plluzhinë

Përmes përrurimit të pllakave "Bazë e UÇK"-së në shtëpitë e Hasan Tahirit dhe Idriz Nurakut në Plluzhinë të Skenderajt, presidenti Hashim Thaçi ka thënë se po kujtojnë dhe nderojnë rezistencën e luftës për liri të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës



dhe respektohen familjet e dëshmorëve, invalidët, veteranët, atëherë vendi është në rrugë të sigurë. "Sot, mesazhi im, si mik i juaji, si bashkëluftëtar i juaji në vitet më të rënda për komb, por

edhe më krenaret për vendin tonë, është të qëndroni siç keni qenë gjithmonë, të bashkuar edhe në luftë, edhe në paqe, edhe më tutje. Vetëm të bashkuar arritëm të kemi sukses", ka thënë ai.

Duke iu drejtuar familjeve Tahiri dhe Nuraku në Plluzhinë të Skenderajt, presidenti Thaçi theksoi se shteti i Kosovës në mënyrë institucionale po respekton dhe nderon rezistencën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në këtë trevë, në fshatin Plluzhinë, Ticë, Likoc dhe gjithë këtë hapësirë, që ishte bërthama e masivizimit të Ushtrisë Çlirimtare për tërë Kosovën. "Ne të gjithë jemi dëshmitarë se këtu erdhën për t'u shpërndarë në gjithë Kosovën veprimtarët më të mirë të kombit. Këtu erdhi edhe Fehmiu, edhe Xheva, edhe komandant 'Kumanova' dhe shumë e shumë komandantë të tjerë që ranë në istikamet e lirisë, për t'u shpërndarë më pas anekënd Kosovës,

për ta zgjeruar frontin e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe nuk ishte e rastësishme pse erdhën këtu fillimisht. Erdhën sepse këtu kishte filluar lufta. Këtu nuk kishte më Serbi, por kishte organizim. Këtu ishte Ushtria Çlirimtare e Kosovës", ka thënë presidenti Thaçi.

Kreu i shtetit shprehu mirënjohjet më të larta për të gjithë ata që luftuan për lirinë e Kosovës dhe për familjet e dëshmorëve. "Kanë rënë shumë heronj, shumë dëshmorë. Çdoherë që vijmë këtu dhe çdoherë që trokasim dhe hyjmë këtu, hyjmë në shtëpitë që kanë qenë shtab i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Vetëm ai mobilizim i përgjithshëm bëri që ne të fitojmë", ka thënë ai, duke shtuar se përmes përrurimit të pllakave "Bazë e UÇK"-së në shtëpitë e Hasan Tahirit dhe Idriz Nurakut në Plluzhinë të Skenderajt, po kujtojnë dhe nderojnë rezistencën e luftës për liri të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

EPOKA ERE Qendresa RAMA

SKENDERAJ, 26 MAJ - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, të dielën ka marrë pjesë në përrurimin e pllakave "Bazë e UÇK"-së në shtëpitë e Hasan Tahirit dhe Idriz Nurakut në Plluzhinë të Skenderajt. Presidenti Thaçi ka thënë se kjo është një zonë e rezistencës së jashtëzakonshme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. "Është mirë që vlerat e sublimë të kombit, vlerat e luftës, vlerat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pavarësisht kohës, pavarësisht sa po kalojnë vitet, përsëri janë ato që na ofrojnë të gjithëve dhe na bashkojnë në çdo moment kudo që jemi si komb. Drenica është bastioni ku lindi, u zhvillua, u rrit dhe më pas u masivizua në tërë Kosovën, Ushtria Çlirimtare e

Kosovës. Nuk lindi rastësisht në Drenicë, nuk lindi rastësisht prej bijave dhe bijve më të mirë të kombit, të atyre familjeve që brez pas brezi kontribuuan për lëvizjen çlirimtare të Kosovës, për lëvizjen kombëtare. Nuk lindi rastësisht në Drenicën e Hasan Prishtinës, të Azem Bejtës, të Shotë Galicës, të Shaban Polluzhës, Mehmet Gradicës, Fazli Graçevcit e shumë e shumë atdhetarëve që janë monumente të lëvizjes kombëtare gjithëshqiptare. Pikërisht nga kjo frymë patriotike e bartur brez pas brezi të shumë gjenerata, erdhi momenti i rezistencës më të fuqishme, i projektit më madhor kombëtar dhe më të organizuar politik e ushtarak, Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", u shpreh presidenti Thaçi, duke shtuar se përderisa respektohen këto vlera



Zgjidhet problemi i banorëve të fshatit Doganaj për rrugën

KAÇANIK, 26 MAJ (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëherësh lider i koalicionit qeveritar, ka takuar të dielën banorët e fshatit Doganaj në Kaçanik për ta zgjidhur kërkesën e tyre për rregullimin e rrugës lokale që është dëmtuar gjatë punimeve të autostradës Prishtinë - Shkup. Në këtë takim, ku ishin të pranishëm edhe përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës, kryeparlamentari Kadri Veseli ka kërkuar që kërkesat e banorëve për këtë rrugë të plotësohen menjëherë dhe rruga të kthehet në gjendjen e mëparshme. Përveç kësaj rruge, Veseli i ka siguruar banorët se do të ketë edhe investime të tjera në

këtë zonë. "Bashkë me kryetarin e Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazin dhe përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës, takuam banorët e fshatit Doganaj, me të cilët diskutuam dhe u pajtuam për kërkesën e tyre që rruga e dëmtuar gjatë punimeve në autostradën 'Arbën Xhaferi' të rregullohet shumë shpejt. Përveçse u zotuar për zgjidhjen e menjëhershme të këtij problemi, banorët i siguroam se në këtë zonë të rëndësishme të Kosovës do të ketë investime të vazhdueshme infrastrukturore dhe ekonomike", ka thënë Veseli pas takimit me banorët e fshatit Doganaj në Kaçanik.



Veseli: Të luftohet korrupsioni

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, në një takim të dielën me strukturat e reja të Degës së PDK-së në Vushtrri, ka folur edhe për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, ku ka bërë thirrje për luftim më të madh të këtyre dukurive negative me më shumë guxim në mënyrë që mos të mbrohet askush, pavarësisht prej përkatësisë partiake

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

VUSHTRRI, 26 MAJ - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, ka takuar të dielën në Vushtrri strukturat e reja të Degës së PDK-së në prani të udhëheqësve qendrorë e lokalë partiakë. Ai ka folur për vizionin e "Dekadës së Re" në dekadën e tretë të lirisë dhe të dytën pas pavarësisë. "Nuk ka forcë që mund të na ndalë në rrugën e reformave rrënjësore për të krijuar mundësi për njerëz me energji të reja, me inovatorë e ndërmarrës që do ta zhvillojnë më fuqishëm ekonominë e vendit tonë. Ne do të merremi me projektet e së ardhmes, me 'Dekadën e Re', për Kosovën e integruar drejt Bashkimit Evropian, në NATO dhe partneritetet me ShBA-në. Ky është vizioni dhe qëllimi ynë për të ardhmen", ka thënë Veseli, duke shtuar se përkushtimi i

"Dekadës së Re" është një trashëgimi e UÇK-së dhe e gjeneratave të mëhershme që ka kulmar me luftën e UÇK-së. "E ardhmja është përgjegjësi e neve që jemi gjallë, neve që e duam këtë vend dhe që dëshirojmë që fëmijët të rriten në këtë vend dhe të kenë perspektivë, të jetojnë më mirë. Kjo është përgjegjësi e Dekadës së Re, është përgjegjësi e PDK-së", ka deklaruar Veseli.

Duke folur për shumë projekte të realizuara nga qeverisja e PDK-së në Vushtrri, kryetari Veseli ka pohuar se shumë prej tyre ende po vazhdojnë sot të realizohen. Ndërsa duke folur para strukturave të reja partiake në Vushtrri, Veseli ka thënë se në mbarë vendin kanë marrë pjesë më shumë se 50 aktivistë në zgjedhjet e PDK-së, të cilat kanë rezultuar me një reformë substanciale ku më shumë se gjysma e kryetarëve të nëndegëve dhe degëve janë zgjedhur të rinj. "Në këto



zgjedhje të brendshme PDK-ja ka filluar me një vizion të ri dhe, përveç procesit zgjedhor e reformues, është vizion i ri, është energji e re për Kosovën, për proceset euroatlantike, në rrugën e së cilës Kosova do të dalë suksesshëm dhe faqebardhë", ka thënë Veseli.

Ndërsa rreth iniciativës për tribunalin për dënimin e krimeve serbe në Kosovë, ai ka theksuar se iniciativa ka për qëllim të sjellë drejtësi për mijëra viktima të gjenocidit serb. "Nuk do të lejojmë që historia të përsëritet. Ne do të përgatitemi që të jemi më të fortë dhe më të zhvilluar. Nuk duam hakmarrje, por drejtësi, si komb dhe si shtet. Serbia duhet

të përgjigjet për gjenocidin ndaj shqiptarëve, në mënyrë që të jetojmë në paqe me të gjithë fqinjët dhe t'i hapim perspektivë Ballkanit Perëndimor, e bashkërisht të ecim drejt Bashkimit Evropian dhe NATO-s", ka thënë Veseli.

Lideri i PDK-së foli edhe për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, ndërsa bëri thirrje për luftim më të madh të këtyre dukurive negative me më shumë guxim në mënyrë që mos të mbrohet askush, pavarësisht prej përkatësisë partiake. "Unë besoj se Kosova do të rrugëtojë suksesshëm, do të bëjë më shumë në proceset zhvillimore drejt Bashkimit Evropian.

Njerëzit e presin këtë nga ne. Kjo do të arrihet përmes një koncepti dhe vizioni që jemi duke e zhvilluar në 'Dekadën e Re'. Asetin themelor, kapitalin human, ta përdorim në mënyrë adekuate, për inovacion, ndërmarrësi dhe resurse natyrore", ka theksuar Veseli. Kryetari i Degës së PDK-së në Vushtrri, Kurtan Kajtazi, ka diskutuar për procesin e suksesshëm zgjedhor në Vushtrri, strukturën prej 59 nëndegëve, e ku në qytet prej pesë nëndegëve janë bërë 11 nëndegë dhe beson se strukturat që janë zgjedhur, në qytet dhe në të gjitha fshatrat, do të shihen me angazhimin e mëtutjeshëm.

Shyqyri Haxha: Telekomi ende nuk është gati për privatizim



PRISHTINË, 26 MAJ - Dikur ishte ndërmarrja më fitimprurëse në vend, kurse sot thuhet se punon me humbje. Prandaj po këmbëngulet që sa më shpejt të përfundojë procesi i privatizimit të ndërmarrjes publike Telekomi i Kosovës. Por, sipas ish-kryeshëfit ekzekutiv të Postës dhe Telekomit të Kosovës, Shyqyri Haxha, kjo ndërmarrje ende nuk është e gatshme për privatizim. Sipas tij, ky proces duhet të bëhet pas një plani të hollësishëm i cili do të tërhiqte kompani me

botërore.

Haxha në një intervistë dhënë për "arbresh.info" ka thënë se nëse privatizimi ndodhë tani nuk do të sillte kurrfarë leverdie ekonomike. "Privatizimi i Telekomit në këto rrethana nuk ka leverdi ekonomike dhe nuk do të duhej të ndodhte. Reputacioni i Telekomit të Kosovës është dëmtuar tej mase, prandaj ky ka ndikim edhe në ofertuesit potencialë me renome dhe liderë botërorë në sektorin e Telekomit", ka thënë Hoxha. I pyetur se kujt po i konvenon

kjo ngutje për ta privatizuar Telekomin, Haxha ka thënë se Kosovës dhe qytetarëve të saj jo. "Unë nuk kam ndonjë informatë se kujt i konvenon, por ajo që dihet saktë, është se Kosovës dhe qytetarëve të saj një privatizim në këto rrethana nuk u konvenon. Privatizimi i Telekomit nuk duhet të bëhet për 'apetite' të bizneseve private, sepse kjo dëmton interesin nacional. Qeveria dhe ministrinë përkatëse duhet të kenë shumë kujdes me privatizimin e resurseve shtetërore, sepse këtu qën-

dron 'thelbi' i zhvillimit dhe qëndrueshmërisë ekonomike dhe politike të mëtutjeshmet të shtetit të Kosovës", ka thënë ai. Haxha ka shtuar se institucionet duhet të kenë shënjestër kompanitë nga Britania e Madhe, ShBA-ja dhe Gjermania. "Institucionet e Kosovës duhet të përpilojnë një strategji të privatizimit të hollësishëm. Të debatohet dhe analizohet mirë nga ekspertë me background kombëtar, në mënyrë që të merren parasysh interesat kombëtare, posaçërisht prioritet

duhet të jetë tërheqja e kompanive të Telekomit nga shtetet perëndimore që kanë ndihmuar Kosovën në ditët më të vështira të çlirohet nga okupimi serb. Posaçërisht kompanitë nga Britania e Madhe, ShBA-ja, dhe Gjermania duhet të jenë me prioritet nacional. Natyrisht nuk duhet përfshirë as kompanitë nga vendet e tjera mike, por këto tri shtete duhet të jenë në top listë të prioritetit nacional", ka thënë Haxha, i cili ka shtuar se Telekomi nuk bën të bëhet barrë e shtetit të Kosovës.

Dukuria e rrezikshme e fajdeve

PRISHTINË, 26 MAJ - Dukuria e huazimit të parave në mënyrë ilegale, apo si njihet me termin "fajde", mbetet mjaft shqetësuese në Kosovë. Kjo dukuri theksohet se po sjell pasoja të mëdha për shoqërinë në përgjithësi.

Gjatë javës që lamë pas Policia e Kosovës ka realizuar një operacion të gjerë policor, i cili ka përfshirë rajonin e Prishtinës, Pejës dhe Gjakovës. Si rezultat i hetimeve dhe veprimeve policore janë arrestuar pesë persona, përdërisa dy mbeten në kërkim policor.

Vlera e përgjithshme e përfituar nga të dyshuarit në mënyrë të paligjshme vlerësohet të jetë më shumë se 2.5 milionë euro, ndërsa dëmi i përgjithshëm i shkaktuar dyshohet se është mbi 6 milionë. Ndërkohë, në disa video-incizime, të publikuara këtë javë në mediat lokale në Kosovë, vërtetësinë e të cilave "Radio Evropa e Lirë" nuk e ka konfirmuar, shihen disa persona të dyshuar për vepra kriminale duke marrë para dhe duke u thirrur edhe në emrin e kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli.

Ngjarja thuhet se ka ndodhur në vitet 2012-2013. Pas përfoljes së emrit të tij, ka reaguar

edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, i cili ka njoftuar se ka deponuar kallëzim penal në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, për shkak të, siç thotë, "keqpërdorimit të emrit tim nga një grup kriminal". "Do t'i shkoj deri në fund qartësimi të këtij rasti dhe sjelljes para përgjegjësisë penale të atyre që e kanë bërë krimin dhe atyre që e kanë fshehur krimin për gjashtë vjet", ka thënë Veseli.

Në një përgjigje dërguar "Radios Evropa e Lirë", Policia e Kosovës konfirmon se Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit gjatë periudhës janar-maj ka arrestuar tetë persona për kryerjen e veprës penale fajde. Derisa sipas Policisë së Kosovës, gjatë vitit të kaluar, nën dyshimin për kryerjen e kësaj vepre penale, ishin arrestuar 14 persona. "Mbi bazën e dyshimeve të arsyeshme (burimet e informacioneve të hapura/mbyllura), Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, është duke operuar me të gjitha kapacitetet e saj që ka në dispozicion, në kuadër të Planit Operativ 'Fajde-ja', për luftimin e veprës penale", thuhet në përgjigjen e Policisë së Kosovës.



Për t'i luftuar këto dukuri, ekspertë të çështjeve ekonomike dhe të sigurisë thonë se organet kompetente duhet të jenë më efikase.

Eksperti i çështjeve ekonomike, Naim Gashi, ka thënë se grupet e tilla kriminale kanë ekzistuar në Kosovë me vite, e të cilat, si pasojë e moshetimit efikas të sistemit të drejtësisë, atyre u është dhënë mundësia që të forcohen. "Fatkeqësisht, policia dhe Prokuroria e

Kosovës po e shohin këtë fenomen 20 vjet pasi ka ndodhur. Qytetarët e dinë që ekzistojnë fajdexhinjtë, ndërsa vetëm policisë dhe prokurorisë pas 20 vjetësh u ka ra ndërmend se ekziston ky fenomen jashtëzakonisht i rrezikshëm për shoqërinë", ka thënë Gashi. Sipas tij, pasojat e kësaj dukurie janë jashtëzakonisht negative për arsye se shkatërrohen familje të tëra nga grupe të caktuara kriminale.

Veprimet e tilla kriminale, siç është fajdeja, ndëshkohen sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Sipas këtij kodi, kushdo që për vete apo për personin tjetër pranon ose kontraktin një shumë dukshëm joproportionale të pasurisë, në këmbim të shërbimit për personin tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim prej 5 deri në 12 vjetësh, varësisht nga vlera e humbjeve të mjeteve financiare ose realizimit të pasurisë.

MTI-ja ndan 40 hektarë për projektin 'Parku Ekonomik për Bizneset nga Diaspora në Malishevë'

PRISHTINË, 26 MAJ (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për projektin "Parku Ekonomik për Bizneset nga Diaspora në Malishevë", bashkë me Ministrinë e Diasporës dhe Unionin e Bizneseve Shqiptaro-Gjermane.

Ministri Shala ka thënë se ashtu siç kanë kontribuar për mirëqenien ekonomike dhe sociale të vendit tonë për dekada me radhë, ashtu siç kanë kontribuar për çlirimin e Kosovës, tash është koha që bizneset nga diaspora të kontribuojmë edhe në zhvillimin ekonomik. "Është hera e parë që Qeveria e Kosovës iu ofron mundësi konkrete përfaqësuesve të bizneseve të diasporës për investime në Kosovë. Ky është vetëm hapi i parë dhe, sipas kërkesave të bizneseve, do t'u ofrojmë edhe lehtësira të tjera në mënyrë që zhvillimin ekonomik të vendit tonë ta bëjmë së bashku", ka thënë ministri Shala. Sipas tij, diaspora ka rol të pamohueshëm në ndërtimin e Kosovës për dekada me radhë dhe se, po mos të ishte diaspora, as sot Kosova nuk do të ishte kështu. "Falënderues përjetësisht për atë që keni bërë



për Kosovën. Por tash është koha që edhe qeveria e vendit tuaj t'ju krijojë kushte që kapitalin tuaj ta investoni në Kosovë, duke ndikuar në rritjen ekonomike dhe hapjen e vendeve të reja të punës", ka thënë Shala.

Ministri Shala ka bërë me dije se MTI-ja do të jetë adresë e shqetësimeve të bizneseve të diasporës në çdo kohë që kanë nevojë. "Ministria e Tregtisë dhe Industrisë do të jetë adresa e juaj 356 ditë të vitit që ju t'i adresoni shqetësimet tuaja, nëse i keni, dhe do të punojmë shumë që bizneset e diasporës të kenë kushte dhe mundësi që të punojnë në Kosovë", ka thënë Shala.

Qëllimi i kësaj marrëveshje të bashkëpunimit është realizimi i projektit "Parku Ekonomik për Biznese nga Diaspora në Malishevë" dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë zotohet që pronën e Parkut Ekonomik do të japë në shfrytëzim për investitorët nga diaspora sipërfaqen në fazën e parë prej 15 hektarëve, me mundësi rritjeje në 40 hektarë për 99 vjet. MTI-ja zotohet ta financojë ndërtimin e infrastrukturës në Parkun Ekonomik.

Kryetarët e odave ekonomike të ballkanit perëndimor me ide konkrete për avancimin e bashkëpunimit rajonal

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 26 MAJ - Kryetarët e Odave Ekonomike të Ballkanit Perëndimor, njëherësh anëtarë të Bordit Menaxhues të Forumit Investiv të këtyre odave, i njohur me shkurtesën CIF (Chamber Investment Forum), kanë zhvilluar një takim të përbashkët në Odën Ekonomike të Kosovës në Prishtinë, ku kanë diskutuar për aktivitetet e radhës dhe për idetë konkrete që nxisin bashkëpunimin rajonal dhe ndihmojnë integrimin ekonomik. Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, si nikoqir i këtij takimi, gjatë fjalës së tij ka thënë se qëllimi kryesor i Forumit Investiv të Odave të Ballkanit Perëndimor (CIF) dhe takimeve të tilla është nxitja e bashkëpunimit ekonomik në mes vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ai ka theksuar se rajoni ynë ka nevojë për investime dhe, sipas tij, një treg i përbashkët mund të jetë shumë atraktiv dhe me

potencial për të tërhequr kompani të mëdha botërore për të investuar.

Rukiqi në fjalën e tij ka shtuar se një ndër qëllimet e organizatës CIF është ta lehtësojë rrugën e vendeve tona drejt BE-së duke nxitur bashkëpunimin ekonomik. "Duke treguar se, pavarësisht çdo problemi politik, ne mund të ecim përpara me iniciativat tona sepse bizneset kanë nevojë për lehtësim të rrugës për tregti dhe investime", ka thënë ai.

Kryetarja e Unionit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë, Ines Mucostepa, ka theksuar se bashkëpunimi rajonal në fushën ekonomike është shumë i rëndësishëm për të gjithë, jashtë çdo ngjyrë politike. Ajo ka thënë se integrimi ekonomik është hallka më e fortë që do t'i çojë vendet e Ballkanit Perëndimor drejt integritimit në Bashkimin Evropian.

Pjesë e delegacionit që vizitoi Prishtinën dhe Prizrenin ishte edhe kryetari i Bordit Menaxhues të CIF-it, njëherësh kryetar i Odës

Ekonomike të Serbisë, Marko Cadez, i cili ka thënë se vendet e Ballkanit Perëndimor nuk kanë më kohë për të humbur dhe se duhet të bashkëpunojnë në mënyrë që secili shtet të përfitojë dhe të gëzojë zhvillim ekonomik. Ai përmendi disa aktivitete rajonale të rëndësishme, mes të tjerash, edhe aktivitetin që do të mbahet në Londër në bashkëpunim me "Financial Times", ku do të prezantohet rajoni i Ballkanit Perëndimor si destinacion për investime.

Kryetari i Odës Ekonomike të Maqedonisë Veriore, Branko Azeski, ka pohuar se një bashkëpunim më i mirë në mes të vendeve të Ballkanit Perëndimor do t'i dërgonte një mesazh pozitiv edhe institucioneve evropiane. Ai ka deklaruar se "bashkëpunimi rajonal është obligim ngaqë është turpëruese të kemi bashkëpunim më të mirë ekonomik me një vend që është 2 000 kilometra larg nesh sesa me njëri-tjetrin". Azeski ka theksuar se kompanitë në Ballkanin Perëndimor kanë nevo-

jë për një komunikim më të mirë dhe se do të shfrytëzojnë modelet e përafërt me atë nordik për ta përmirësuar këtë mangësi.

Ndërsa kryetari i Odës Ekonomike të Malit të Zi, Vlastimir Golubović, gjatë fjalës së tij përmendi disa iniciativa dhe projekte rajonale në kuadër të Forumit Investiv të Odave të Ballkanit Perëndimor që lidhen me fusha të ndryshme si aftësim profesional, digjitalizim dhe projekte të tjera të cilat do të realizohen në vitet në vazhdim. Ai ka shtuar se ky takim është një mundësi e mirë që së bashku t'i ndajmë shqetësimet e të gjithë ndërmarrësve që përfaqësojmë dhe t'u dërgohet mesazh të gjithë atyre që kanë mundësi për t'iu përgjigjur këtyre sfidave.

Sekretari i përgjithshëm i CIF-it, Safet Gërxhaliu, ka thënë se nga ky takim mund të nxirren mesazhe të rëndësishme për të ardhmen e rajonit dhe në këtë drejtim ai ka thënë se duhet të pajtohen se dialogu dhe bashkëpunimi rajonal nuk kanë

alternativë.

Prania e kryetarëve të Odave Ekonomike të Ballkanit Perëndimor është mesazh për politikën se ardhmëria na takon gjithë neve, shtoi ai, duke thënë se fati më i madh te vendet e Ballkanit perëndimor është se bashkëpunimi ekonomik ka bërë hapa më të avancuar se politika. Delegacioni i përbërë nga kryetarët e odave të ballkanit perëndimor ka vizituar edhe Parkun e Inovacionit dhe Trajnimeve në Prizren, duke parë nga afër potencialin dhe të mirat që mund të sjellë ky park në funksion të zhvillimit ekonomik.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka theksuar se parku inovativ dhe i trajnimeve si projekt gjermano-kosovar është shumë i rëndësishëm në radhë të parë për punësimin e të rinjve, duke nxitur aftësimin profesional, zhvillimin e kapitalit human dhe në të njëjtën kohë të aktiviteteve inovative që mundësojnë për shumë kompani të jenë më konkurruese në tregjet evropiane.



Murtezaj: Bizneset i kanë borxh ATK-së rreth 350 milionë euro

PRISHTINË, 26 MAJ - Drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ilir Murtezaj, ka bërë me dije se biznese të ndryshme i kanë mbetur borxh ATK-së rreth 350 milionë euro. "Në Administratën Tatimore të Kosovës kemi pasur borxhe të pambledhura si institucion, ku tatimpaguesit e ndryshëm që kanë pasur vështirësi financiare kanë mbetur borxh ndaj

ATK-së. Aktualisht, shumica e borxhit që bizneset kanë ndaj ATK-së është rreth 350 milionë euro, shumë kjo përtej limitit të lejuar ndërkombëtar. Dhe në këtë drejtim, ne kemi bërë sforcimet tona për ta respektuar ligjin fillimisht, pastaj edhe për t'i inkasuar këto borxhe", ka thënë Murtezaj për "Radion Evropa e Lirë". Ai ka treguar se për 10 vjet radhazi nuk kanë pasur masa të konfiskimit,

ndërsa vetëm në dy muajt e fundit, si rezultat i veprimeve shtesë që kanë realizuar, kanë zhvilluar 110 raste të proceseve të konfiskimeve, raste këto që kanë rezultuar me inkasim të borxheve në vlerë prej 2.6 milionë eurosh. "Ky proces do të vazhdojë edhe më fuqishëm në drejtim të realizimit ose inkasimit të borxheve të papaguara", ka thënë Murtezaj.



Këtë vit do të jetë e gatshme qendra e banimit social në Malishevë

MALISHEVË, 26 MAJ (ER) - Qendra e banimit social, një objekt kapital që pritet ta zgjidhë problemin e strehimit për rreth 40 familje, është duke u ndërtuar sipas dinamikës së paraparë dhe pritet që të jetë e gatshme brenda vitit. Kjo qendër e banimit social është një objekt me rëndësi për Komunën e

Malishevës, ndërsa ndërtimi i saj mundësohet falë bashkëfinancimit në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, që e bartë pjesën më të madhe të financimit dhe Komunës së Malishevës dhe ka një kosto prej 650 mijë eurosh, ndërsa ndërtimi i saj ka filluar në tetor të vitit të kaluar.

Punimet në këtë objekt i ka parë nga afër nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, i cili është njoftuar me ecurinë e punimeve. Ai ka thënë se ky objekt, krahas vlerës kapitale, ka rëndësi të madhe në aspektin social, pasi pritet të futen 40 familje të cilat e kanë problem çështjen e strehimit.



Shpërndahen 400 pako ushqimore për familjet në nevojë në Kamenicë

KAMENICË, 26 MAJ (ER) - Komuna e Kamenicës, në bashkëpunim me Organizatën "Qëndresa Kosovare", "Jetimat e Ballkanit" dhe "Qatar Charity", kanë shpërndarë 400 pako ushqimore për familjet në gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale.

Në shenjë solidariteti për këto familje, organizata "Qatar Charity" ka dhuruar 300 pako ushqimore, "Qëndresa Kosovare" 50 pako dhe "Jetimat e Ballkanit" 50 pako. Kryetari i

Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka falënderuar organizatat për kontributin e tyre. "Është e dhimbshme që edhe 20 vjet pas luftës ka familje që përballen me vështirësi financiare, por po mundohemi që sadopak t'ua bëjmë më të lehtë", ka thënë Kastrati. Këto pako janë shpërndarë në koordinim me Qendrën për Punë Sociale (QPS) në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.



Përkujtohen të rënët në 20-vjetorin e masakrës së Tusuzit

PRIZREN, 26 MAJ (ER) - Nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, të dielën para memorialit dhe varrezave të 27 martirëve të "Lagjes së Trimave" është organizuar një akademi përkujtimore me rastin e 20-vjetorit të Masakrës së Tusuzit. Në këtë akademi kanë pranishëm edhe lideri i Vetëvendosjes, Albin Kurti, dhe

kryetari i Degës së Nismës Socialdemokrate në Prizren, Zafir Berisha.

Në emër të Komunës së Prizrenit dhe kryetarit Haskuka, kryesuesi i Kuvendit Komunal, Artan Abrashi, ka shprehur ngushëllimet për familjarët e martirëve dhe ka kërkuar drejtësi për gjetjen dhe dënimin e shkaktarëve të këtij krimi. Gjithashtu, në këtë akademi

fjalën e kanë marrë edhe veprimtarë dhe aktivistë të çështjes kombëtare, kontribuues për liri dhe përfaqësues të lagjes e të shoqatave të dala nga lufta. Masakra e Tusuzit njihet si ngjarja më e rëndë në qytetin e Prizrenit gjatë kohës së luftës, ku në operacionin brutal të njësisë kriminale serbe ishin masakruar 27 martirë dhe djegur rreth 250 shtëpi të kësaj lagjeje.

Qytetarët e Skenderajt të kënaqur me mirëmbajtjen e parqeve publike

SKENDERAJ, 26 MAJ (ER) - Në funksion të mirëmbajtjes dhe pastërtisë në parqe dhe hapësira të tjera publike, Komuna e Skenderajt ka angazhuar këto ditë punëtorët e mirëmbajtjes, në mënyrë që qytetarët të kenë sa më shumë hapësira pa mbeturina ku do të mund të kalohet koha e lirë.

Dy drejtorët e kësaj komune, ai i Inspeksionit dhe i Shërbimeve Publike, Arton Veliu e Gëzim Ejupi, kanë vizituar parkun "Shaban Polluzha" dhe "Parkun Amerikan", ku kanë parë nga afër

gjendjen e mirëmbajtur të këtyre hapësirave publike që frekuentohen shumë nga qytetarët, sidomos nga pensionistët dhe të tjerët. Pensionistët të cilët vizitojnë jo rrallëherë parkun "Shaban Polluzha" janë shprehur falënderues ndaj komunës, veçmas ndaj kryetarit Bekim Jashari për angazhim në mirëmbajtje të parqeve me karakter publik. Në këtë mënyrë, gjatë kësaj jave janë vendosur edhe shportat e mbeturinave përgjatë rrugëve kryesore të qytetit.



A duhet Qeveria e Kosovës ta njohë zyrtarisht hapësirën kibernetike si një kufi të edukimit dhe të mbrojtjes nacionale



Rahmil LIMANI

Siguria kibernetike është sfidë e re për shoqërinë dhe institucionet e Kosovës, prandaj për këtë qëllim nevojitet rritje e kapacitetit në shkallë të gjerë, në drejtimin e teknologjisë informative në përgjithësi, për t'i arritur nivelet më të larta të sigurisë nacionale dhe për t'i mbrojtur institucionet shtetërore, organizatat e ndryshme të shoqërisë, demokracinë e vendit, ekonominë digjitale, pasi edhe për këtë kërkohen investime në produktet konkrete të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në këtë proces.

Lufta kibernetike sot është një betejë reale, kur dihet se çdo e dhënë që kalon online në kompjuter është e rrezikuar. Institucionet tona të sigurisë duhen të ndërmarrin masa në

këtë drejtim, t'i njohin hapësirat kibernetike për identifikimin dhe luftimin e këtij fenomeni. Në institucionet tona qeveritare problematika kryesore është se sistemet tona të sigurisë nuk janë mjaftueshëm të sigurta, që të na ofrojnë mbrojtje nacionale nga këto lloj sulmesh. Në disa raste, institucionet janë ndeshur në fenomene të tilla si shembull të një dëshmie digjitale ose prova elektronike. Ka pasur probleme të natyrës së tillë ku është vërejtur mungesa e personave zyrtarë përgjegjës institucionalë të specializuar për t'i trajtuar këto çështje në kuadër të mekanizmave të sigurisë, siç janë policia, prokuroria dhe gjyqësori.

Nga institucionet shtetërore të sigurisë së Kosovës (MB - si koordinatore përgjegjëse), përveç nxjerrjes së një strategjie shumë përfshirëse për sigurinë kibernetike, në vitin 2016 nga një grup punues i Qeverisë së Kosovës dhe disa trajnimeve të realizuara në kuadër të bashkëpunimit me mekanizmat e EU-së në kuadër të projektit CRG3 me zyrtarë të MB-së, nuk i është dhënë rëndësi sa duhet dhe nuk janë marrë masa të duhura për rritjen e interesit institucional dhe ngritjen e vlerës së sektorit të inteligjencës artificiale në fushat kryesore të vendit, si ajo civile dhe ushtarake.

Për t'i përballuar me sukses këto sfida, në të ardhmen institucionet shtetërore të sigurisë duhet të bazohen në ndërtimin e programeve dhe ekipe ekspertësh, që t'i nënshtrohen një programi rrënjësor, në transformimin dhe modernizimin e trajtimit të problemeve të tilla, përmes të cilëve të bëhet i mundur trajtimi i këtyre veprave penale në fushën e krimeve kompjuterike. Duke u

referuar të dhënave të fundit zhvillimore të këtij lëmi dhe rreziqet që do të vijnë për shoqërinë, në veçanti për institucionet e vendit, institucionet shtetërore të sigurisë, në bashkëpunim me ato të arsimit, është e nevojshme të prezantohet në institucionet arsimore edhe si problem akademik për edukimin e gjeneratave të reja në të ardhmen për sigurinë kibernetike, (edhe pse ka filluar në arsimin e lartë profesional si lëndë zgjedhore), të mblidhet stafi më i lartë akademik për të përpiluar planprograme, që të futet si lëndë e rregullt shkollore në shkollat e mesme dhe të larta, duke parë ecurinë e këtij lëmi dhe nevojat e kërkesat për ekspertë në të ardhmen e afërt në këtë drejtim. Duke u bazuar në përparimin e fundit të BE-së dhe shtimin e bashkëpunimit brenda vet

vendeve të unionit, por edhe vendeve të rajonit, mendoj se platformat e qeverisë sonë duhet t'i hyjnë përpilimit të strategjisë kombëtare nga dikasteret e sigurisë siç janë MB, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes, kjo e fundit është një dikaster i ri në zhvillim, shumë i rëndësishëm në sigurinë nacionale, që duhet të sigurojë burime dhe teknologji të kohës, të ketë një staf profesional të trajnuar mirë në zhvillimin e këtij sektori, t'i shtojë trajnimet dhe seminarat në sigurinë kibernetike në kuadër të partneritetit të aleancës më të fuqishme të mbrojtjes, NATO.

Duke investuar në mbrojtjen e sigurisë kibernetike dhe aftësive operacionale do t'u jepet një mbështetje e fortë institucionale këtyre grupeve punuese në bashkëpunim mes zyrtarëve të dikastereve të ndryshme shtetërore të sigurisë, në fushat e ndryshme juridike dhe specialistëve të IT-së, OJQ-ve, të shfrytëzohet bashkëpunimi publiko-privat. Të mbështeten edhe iniciativa dhe projektet në kuadër të përkrahjes së bashkëpunimit të EU-së dhe me vendet anëtare dhe joanëtare të EU-së të reformave në sektorin e sigurisë në Ballkanin Perëndimor (dhe unifikimin legjislativ), me mekanizmat e EU-së përgjegjëse për këto çështje siç është agjencia e sigurisë ENISA, Evropol / EC3 etj. Prandaj ne si shtet joanëtar i EU-së dhe NATO-s, por me orientim të rëndësishëm pro euroatlantik, duhet ta përgatisim në tërësi infrastrukturën ligjore dhe atë akademike në këtë drejtim që të jemi në gjendje ta rrisim bashkëpunimin në hapësirën kibernetike dhe të mbrojtjes së sigurisë nacionale në përgjithësi me këto organizata.

Ministri Gashi: Tribunali për krimet serbe në Kosovë është i domosdoshëm

PRIZREN, 26 MAJ (ER) - Ministri i Kulturës Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, në nderim të 27 martirëve të Lagjes së Trimave (Tusus), ka bërë homazhe dhe ka vendosur kurora me lule pranë lapidarit të martirëve dhe varrezave të martirëve në këtë lagje. Në pafuqi të përballjes me ushtarët e UÇK-së, forcat serbe në këtë lagje treguan barbarinë e tyre duke i vrarë 27 civilë të pafajshëm dhe i dogjën 245 shtëpi. Lagja e Trimave (Tususi) ishte çerdhe e celulave të para të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për Prizrenin. Kjo lagje gjatë luftës u shndërrua në bazën e ushtarëve të Lirisë.

Heronjtë Xhevat Berisha, Salajdin Berisha e shumë të tjerë, së bashku me Xhemshin

Krasniqin i cili padrejtësisht po mbahet në burg, u vunë në ballë të luftës për lirinë e Kosovës.

Ministri Gashi u shpreh se masakra në Lagjen e Trimave është edhe një dëshmi dhe arsye se tribunali për krimet serbe në Kosovë është i domosdoshëm. "Deri më sot asnjë nga kriminelët që e shkaktuan këtë masakër nuk janë përgjigjur për krimin kundër civilëve të pafajshëm. Asnjë krim i kriminelëve serbë nuk do të kalojë pa u ndëshkuar, prandaj Kosova e ka detyrë dhe obligim themelimit e këtij tribunali. Kosova duhet ta themelojë tribunalin për krimet serbe që dhe autorët e kësaj masacre ta marrin dënimin e merituar", ka thënë ministri Gashi.



Trumpi dhe Bolton, pikëpamje të ndryshme mbi Korenë e Veriut

WASHINGTON, 26 MAJ - Presidenti Donald Trump dhe këshilltari i tij për Sigurinë Kombëtare, John Bolton, duket se kanë pikëpamje të ndryshme lidhur me nivelin e rrezikut që paraqet Koreja e Veriut. Në një postim në "Tweeter" të dielën nga Tokio, Trump i dha një përgjigje Boltonit pas komenteve të tij të shtunën, se nuk kishte asnjë

dysim se prova e kohëve të fundit e Phenianit me raketë balistike me reze të shkurtër veprimi, shkelte një rezolutë të Kombeve të Bashkuara. "Koreja e Veriut lëshoi disa armatime të vogla që shqetësuan disa nga njerëzit e mi e të tjerë, por jo mua", shkruante Trumpi. Presidenti e bëri komentin e tij pak para se të luante golf me

kryeministrin japonez Abe. Më vonë ata ndoqën nga afër një ndeshje sumo dhe Trump i dorëzoi Kupën e Presidentit fituesit të garës.

Sot (e hënë) presidenti Trump pritet të takohet me perandorin Naruhito. Ai do të zhvillojë edhe një takim zyrtar me Abe si dhe do të marrë pjesë në një darkë shtetërore.



Kandidatura e Pat Shanahan për shef të Pentagonit

Pat Shanahanit do t'i duhet të drejtojë këtë institucion të rëndësishëm mes shumë sfidave ushtarake gjatë javëve që vijnë, i cili fillimisht do të duhet të kalojë përmes procesit të vështirë të konfirmimit në Kongres

WASHINGTON, 26 MAJ - Sekretari i Mbrojtjes në detyrë, Pat Shanahan, është i zgjedhuri i presidentit Trump për të drejtuar Pentagonin. Atij do t'i duhet të drejtojë këtë institucion të rëndësishëm mes shumë sfidave ushtarake gjatë javëve që vijnë. Shanahan fillimisht do të duhet të kalojë përmes procesit të vështirë të konfirmimit në Kongres, ka njoftuar voa.

Pas më shumë se katër muajsh pritjeje, ish-zëvendës sekretari i Mbrojtjes tani është kandidat për postin e lartë civil në krye të Pentagonit. Ekspertët thonë se pritja e ka distancuar Shanahan nga largimi tronditës i pararendësit të tij, gjeneralit në pension Jim Mattis, më 1 janar.

"Është e vështirë për të gjetur një biografi aq mbresëlënëse sa të Sekretarit Mattis. Do të jetë i vështirë procesi i zëvendësimit të tij për këdo. Por gjithashtu, nuk duhen nënvlerësuar ato që mund të mësohen gjatë dy viteve në postin e zëvendës sekretarit", thotë Bradley Bowman, i Fondacionit për Mbrojtjen e Demokracive.

Shanahan nuk ka pasur poste qeveritare para se të bëhej pjesë e Pentagonit dy vjet më parë. Së fundi, inspektori i përgjithshëm e gjeti të pastër atë pas një hetimi nëse ai kishte promovuar padrejtësisht punëdhënësin e mëparshëm, kompaninë Boeing. Ndërsa republikanët pothuajse i kanë të sigurta votat për konfirmimin e Shanahan,



demokratët kanë sinjalizuar se ai do të përballet me pyetje të vështira mbi mungesën e eksperiencës së tij në arenën botërore dhe nëse ai mund t'i rezistojë presionit të presidentit Trump, veçanërisht pasi ai pranoi përdorimin nga presidenti të fondeve të Pentagonit për ndërtimin e murit kufitar.

"Ka pasur shqetësim nëse Shanahan do të jetë në gjendje

që ta bëjë me dijeni presidentin kur mendon se një vendim është i drejtë apo i gabuar. Kjo është ajo që pritet gjatë konfirmimit", thotë Bowman.

Por, ky nuk është i vetmi problem. Buxheti i fundit nga Kongresi për ushtrinë ishte i fuqishëm dhe u miratua në kohë. Por, tani që Kongresi është i ndarë në vija politike, prirja e mëparshme nuk ka

gjasa të vazhdojë.

"Shanahan duhet të gjejë një mënyrë për të bashkërenduar ambicien e tij të madhe që shihet me buxhetin e vitit 2020, me strategjinë afatgjatë të sigurisë kombëtare që duket se ka gjasa për burime shumë më modeste për mbrojtjen", thotë Michael O'Hanlon, i Institutit Brookings. Ndërsa shtohen tensionet me Iranin, Shanahan do të jetë në qendër të debatit.

"Administrata e Trumpit po e nxit çështjen e Iranit. Kjo mund të ketë përfundim të mirë ose një fund shumë të keq. Nga Shanahan pres mendim të qetë, por të vendosur, rreth mënyrës se si duhet trajtuar kërcënimi iranian", thotë O'Hanlon.

Pentagoni ka shtuar praninë ushtarake në rajon për t'i kundërshtuar kërcënimet e mundshme iraniane. Udhëheqësit botërorë kanë bërë thirrje për përmbajtje ndërsa të dyja palët thonë se nuk duan luftë.

Hammond thotë se nuk do ta mbështesë një Brexit pa marrëveshje



LONDËR, 26 MAJ - Ministri britanik i Financave, Philip Hammond, tha se do të jetë shumë e vështirë për pasardhësin e kryeministres Theresa May që ta anashkalojë vullnetin e Parlamentit britanik dhe të kërkojë që Britania të largohet nga Bashkimi Evropian pa marrëveshje, duke shtuar se personalisht nuk do të mbështesë një Brexit pa marrëveshje. Disa prej kandidatëve që po

konkurrojnë për postin e kryeministrit të Britanisë kanë thënë se vendi duhet të largohet nga BE-ja më 31 tetor, me ose pa marrëveshje.

Parlamenti britanik ka votuar vazhdimisht kundër një Brexiti (dalja e Britanisë nga BE-ja) pa marrëveshje dhe ministri Hammond tha se nuk beson që Britania mund të largohet nga BE-ja pa një marrëveshje. Sipas Hammond, parlamenti britanik

do të "kundërshtonte me forcë" një Brexit pa marrëveshje. "Do të ishte shumë e vështirë për një kryeministër që aplikon si politikë daljen e Britanisë nga BE-ja pa marrëveshje", tha Hammond.

Më 24 maj, kryeministrja britanike Theresa May njoftoi se do të dorëhiqet nga ky post më 7 qershor, duke shprehur keqardhje që nuk ka mundur ta përfundojë procesin e Brexit-it.

Britania është dashur të dalë nga Bashkimi Evropian më 29 mars, por kryeministrja Theresa May nuk arriti t'i bindë ligjvënësit britanikë për ta votuar marrëveshjen e arritur me udhëheqësit e BE-së. Megjithatë, ajo arriti ta marrë pajtimin e BE-së për shtyrjen e afatit të Brexitit deri më 31 tetor, datë kjo kur Britania duhet të dalë nga BE-ja me ose pa marrëveshje.

Bisedime të reja mes pozitës dhe opozitës venezueliane

KARAKAS, 26 MAJ - Përfaqësues të qeverisë dhe opozitës venezueliane u rikthyen në Norvegji për bisedime që synojnë zgjidhjen e krizës politike në vend. Qeveria norvegjeze njoftoi se javën e ardhshme do të angazhohet në ndërmjetësimin e negociatave mes palëve.

Udhëheqësi i opozitës venezueliane, Juan Guaido, u vetëshpall president i

përkohshëm në fillim të këtij viti, pasi Asambleja Kombëtare që kontrollohet nga opozita doli në përfundimin se Nikolas Maduro nuk gëzonte legjitimitet pasi kishte fituar një mandat tjetër presidencial falë manipulimit të zgjedhjeve. Shtetet e Bashkuara dhe rreth 50 vende të tjera e kanë njohur Guaido si udhëheqësin legjitim të Venezuelës. Megjithatë, ai nuk ka qenë në gjendje ta

largojë nga detyra presidentin socialist të Venezuelës Nicolas Maduro. Ai, gjithashtu, nuk arriti të bindë ushtrinë për t'u ngritur kundër Maduros gjatë një apeli për dezertim në masë më 30 prill.

Përfaqësuesit e të dyja palëve politike ishin në Norvegji edhe më parë gjatë këtij muaji por, sipas njoftimeve, bisedimet mes tyre kanë qenë tejet të tensionuara.





BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.



E jashtëzakonshme

Katër lopë në këmbim të një nuseje

Zakonet e martesës janë të ndryshme në vende të ndryshme të botës. Në Sudan vajza që do ta lërë shtëpinë e saj për të shkuar tek ajo e burrit konsiderohet si një humbje ekonomike. Për këtë arsye dhëndri duhet ta kompensojë këtë "humbje" me katër lopë.



FOTO E DITES



Një fëmijë indian shihet duke lozur në liqenin e thatë në periferi të Chennait. /AFP/

E rrallë

Marinari që i ra përqark botës me pulën e tij

Guirec Soudee, një marinar vetëm 21 vjeç, vendosi të ndërmarrë një udhëtim përreth botës me anijen e tij. Për shoqëri zgjodhi një shok të çuditshëm, pulën e tij Monique. Së bashku ata vizituan Karaibet, Kanadanë, Shtetet e Bashkuara, kaluan Kepin Horn dhe u ndalën në Afrikën e Jugut. Ata madje ndaluan edhe në Grenlandë. Në total, ata udhëtuan më shumë se 83 000 kilometra. Ai



gjithashtu botoi ditarin dhe zbuloi fotografitë e udhëtimit të pabesueshëm me pulën e tij.

BARSOLETA E DITËS



Shkon njëri lakuriq në kafene. Kamerieri, pasi merr porosinë, nuk ia ndan sytë. Ky e vëren këtë dhe pak me nervozë i thotë:
- Çka m'i ke hapur sytë ashtu?
- Veç jam kah të këqyri ku i ke paratë për pagesë, ia kthen kamerieri.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit ne ora 14:00

"DUMBO" 3D

Fantazi/Familjar; 1 ore 52 min

Rolet: Colin Farrell, Michael Keaton, Danny DeVito, Eva Green, Alan Arkin, etj.
Regjia: Tim Burton



Ne ora 16:00 dhe 19:00

"AVENGERS; Endgame"

Aksion/Aventurë/Fantazi; 3 ore 02 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Evans, Mark Ruffalo, Chris Hemsworth, Scarlett Johansson, Don Cheadle, Bradley Cooper, Gwyneth Paltrow, Jeremy Renner, Josh Brolin, etj.
Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 20:00

"EXTREMELY WICKED, SHOCKINGLY EVIL, AND VILE"

Krim/Mister; 1 ore 48 min

Rolet: Zac Efron, Lily Collins, Kaya Scodelario, Jeffrey Donovan, Angela Sarafyan, Dylan Baker, John Malkovich, etj.
Regjia: Joe Berlinger



16.05.2019

"THE HUSTLE"

Komedi

Rolet: Anne Hathaway, Rebel Wilson, Alex Sharp, Dean Norris, etj.

Regjia: Chris Addison



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Keni prioritete, por nuk duhet


asnjëherë t'i vendosni ato përpara familjarëve tuaj. Dikush do të verë re një ndryshim në sjelljen tuaj.



DEMI

Mos ua ktheni në të njëjtën monedhë

personave që janë kundër jush dhe që ju akuzojnë për gjëra pa vlerë.



BINJAKËT

Kjo ditë do të jetë më e vështirë sesa e

mendonit për ju sepse një gjë e papritur që do t'ju ndodhë do ta prishë gjithë rregullin e krijuar.



GAFORRJA

Sot do të kaloni disa orë tensioni dhe

nervozizmi në çift. Përpikuni t'i ulni tensionet sepse mund të përfundojë në një debat të ndezur.



LUANI

Personat që ju duan do të mendo-

hen t'ju këshillojnë të hiqni dorë nga një sipërmarrje mjaft e rrezikshme për ju.



IRGJËRESHA

Sot me ato që po thoni po lini të kuptohet që jeni shumë të ndjeshëm karshi një personi të caktuar. Ndjenjat nuk mund t'i fshihni.



PESHORJA

Ditën e sotme duhet të gjeni aleatë

të fuqishëm për të mbrojtur një projekt që ka kundërshtitë e veta.



AKREPI

Nëse doni të merrni në dorë fatin tuaj sot

mundohuni të qartësoni disa situata të dyshimta.



SHIGJETARI

Në ditët e shkuara keni bërë një gabim

që do t'ju duhet pak kohë për ta rikuperuar. Gjithsesi do të dini si të veproni.



BRICJAPI

Sot një çështje financiare do t'ju

shkaktojë shumë stres. Nëse ju kap paniku nuk do të arrini të zgjidhni gjë.



UJORI

Nëse keni mundësi për të mbaruar

punë sot mos e neglizhoni. Koha nuk ju premtan për të gjitha projektet tuaja.



PESHQIT

Sot do të bëni zgjedhje që shkojnë ndesh me ato që vendosni zakonisht. Do të rezultojnë mjaft produktive.

Nick Jonas kujton takimin e parë me Priyanka Chopra



Aktori i njohur Nick Jonas, në njëvjetorin e takimit të parë me gruan e tij, Priyanka Chopra, e falënderon atë që janë së bashku. Jonas me anë të një postimi në "Instagram" ka shprehur dashurinë e tij që ka ndaj gruas. "Një vit më parë unë me miq shkova të shoh të

'Bukurën dhe Bishën'. Një ndër këta miq ishte gruaja që u bë shoqja ime e ngushtë, qetësia ime, muza ime dhe gruaja ime e bukur. Unë të falënderoj që jemi së bashku në këtë rrugëtim. Ti më bën të qesh çdo ditë dhe më inspiron të jem versioni më i mirë i vetes", ka shkruar Jonas.

Pas abortit, gruaja e Nickut sërish shtatzënë



Nick Carteri dhe gruaja e tij Lauren Kitt janë në pritje të një fëmije sërish. Këtë lajm të lumtur e ka bërë me dije vetë anëtari i grupit Backstreet Boys. "Faleminderit Zot që na dhe dhuratën

më të mirë që mund ta kërkonim! Puthje foshnjës, lumturi dhe familje", ka shkruar ai në "Instagram", ku ka postuar edhe një fotografi së bashku me të birin trevjeçar, Odin dhe gruan shtatzënë.



Dua Lipa shkëlqen në Festivalin e Kanës

Këngëtarja kosovare Dua Lipa ka marrë pjesë në gala mbrëmjen Amfar në Kanë. E veshur

me një fustan të kuq, Dua dukej përballorë derisa vuri pah këmbët e gjata seksi dhe trupin shtatgjatë.

Martohet aktori i njohur Jacob Zachar



Aktori i njohur Jacob Zachar është martuar të shtunën në një ceremoni private me aktoren Brittany Saberhagen. Këtë e ka bërë me dije për "People" vetë aktori duke thënë që janë

martuar në prani të miqve dhe familjarëve. "Brittany dhe unë kemi lidhur sot kurorë para të gjithë miqve dhe familjarëve. Do të vallëzojmë pa undalur", ka deklaruar Zachar.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045 82 82 82

Llumnica dhe Sermaxhaj: Sukseset e 'Niklit', të merituar

Dy trajnerët dhe analistët e futbollit të Kosovës, Ardian Llumnica dhe Genc Sermaxhaj i kanë vlerësuar si të merituar sukseset e Feronikelit në kampionat dhe Kupë. Anë janë të bindur se kjo skuadër me tri apo katër përforcime do të paraqitet mirë edhe në garat parakualifikuese të Ligës së Kampionëve



u dëshmuar me identitetin e lojës se saj në secilën ndeshje duke qenë bindës në detyrat e lojës dhe poashtu më superioritet cilësorë ndaj kundërshtarëve. E vlerësoj lartë punën e trajnerit Zekirja Ramadani, i cili nuk hoqi dorë nga mënyra e lojës se tij pavarësisht kundërshtarëve, gjithashtu nuk pati vetëm një ekip startues, por dy ekipe cilësore ku në mënyrë racionale bënte edhe ndryshimet e lojtarëve startues dhe zëvendësues. Atmosfera e mirë në klub poashtu është një faktor tjetër që të bënë kampion prandaj komplimente për gjitha ato që Feronikeli na ofroi këtë edicion", ka thënë Sermaxhaj. "Feronikelit nuk i duhen shumë përforcime, prandaj besoj se dy ose tri transferime janë të mjaftueshme për të mos e ndryshuar shumë mënyrën e lojës. Shpresoj dhe besoj se do të paraqiten mirë dhe për këtë nuk dyshoj sepse motivi i tyre për të pasur sukses është edhe më i madh, prandaj duhet të vazhdojnë me këtë mënyrë të lojës dhe punës që e kanë bërë, duke qenë më këmbë në tokë dhe të mos vetëkënaqen më këto sukse", ka deklaruar Sermaxhaj.

përforcime. "Nikli ka skuadër të mirë gjithnjë e them në suaza të cilësisë të kampionatit tonë, madje me këtë skuadër që ka jam i bindur që do t'i kalojë edhe këto ndeshje parakualifikuese me sukses, por natyrisht që ka nevojë që të përforcimet. 'Nikli' duhet ta ruaj skeletin e skuadrës dhe më tre-katër përforcime eventuale të freskës skuadrës në disa reparte duke e rritë edhe me shumë konkurrencën sepse mëton të shkojë sa më lartë në fazën e grupeve në garat ndërkombëtare si dhe prapë sezonin e ri ta fillojë për titull", ka deklaruar Llumnica, i cili me pas tregoi emrat që nga lojtarët në Kosovë mund të ishin ideal për këtë skuadër. "Brenda tregut kosovar një futbollist si Ajzeraj i

Ballkanit, Shillova i Flamurtarit, Namani i Llapit apo Krasniqi i Dritës, mendoj se do të ishin produktiv për 'Niklin'", ka shtuar ai. Në fund, Ardian Llumnica i ka sugjeruar skuadrës së Feronikelit të përforcet edhe jashtë fushës, duke angazhuar drejtor sportiv, zëdhënës, staf mjekësor dhe futbollit, Genc Sermaxhaj është në linjë të njëjtë me Ardian Llumnica kur janë në pyetje sukseset e Feronikelit në edicionin që sapo përfundoi. Ish-futbollisti i dëshmuar në disa skuadra të Kosovës, Genc Sermaxhaj mërit të mëdha për sukseset e "Niklit" i japi trajnerit Zekirja Ramadani. "Feronikeli më plot merit është shpallur fitues i titullit dhe Kupës së Kosovës, e cila

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 26 MAJ - KF Feronikeli është shpallur fitues i titullit të kampionit dhe Kupës për edicionin 2018/2019. Trajneri dhe analisti i futbollit të Kosovës, Ardian Llumnica për "Epokën e re" i vlerësoi sukseset e skuadrës nga Drenasi të merituar dhe që kanë krijuar bazën që disa vite. Sipas Llumnicës, Feronikeli dëshmoi se si një skuadër nga një qytet i vogël për pak vite është bërë skuadra më e trofeshme në futbollin e Kosovës dhe model për klubet e mëdha. "Suksesi dhe organizimi i 'Niklit' ka filluar vite më parë duke u shpallur edhe më herët kampion dhe fitues i Kupës, kështu ka filluar baza e një klubi të organizuar si vullnet i njerëzve serioz të Drenasit. 'Nikli' është bërë model se si një klub nga

një qytet i vogël bëhet ndër klubet me të organizuara dhe me të trofeshme në dekadën e fundit në futbollin e Kosovës. Futbollistët dhe stafi teknik pa dyshim që janë mentorët dhe indikatorë direkt në suksesin e 'Niklin', por nuk duhet harruar edhe Presidentin e klubit, Naser Rama që e bartë kuletën e klubit, madje nuk duhet harruar as kryetarin e Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci që ka ditur të afrojë biznesmen të tillë në klub që nuk e kanë problem aspektin financiar, problem që komunat tjera nuk po dinë ende ta zgjedhin. Kalibri i këtij biznesmeni iu duhen klubeve në gjithë Kosovën nëse mëtojnë të kenë trofe, sepse Superliga tashme është bërë e shtrenjtë", ka thënë Llumnica. Trajneri Llumnica më pas ka thënë se drejtuesit e klubit të Feronikelit, duhet që fillimisht të ruajnë skeletin dhe të bëjnë katër

Hamiltoni triumfoi në Monako, Vetteli i dyti

MONACO, 26 MAJ - Lewis Hamilton fiton Çmimin e Madh të Monakos dhe regjistron fitoren e katërt sezonale, duke "vlarë" shumë shpejt garën për titullin kampion në Botërorin e Formulës 1. Piloti britanik, kampion bote në fuqi, ka triumfuar në fundin e një gare më pak të bezdisshme nga ç'ishte parashikuar, duke u ngjitur në shkallën më të lartë të podiumit, përpara Ferrarit të Vettel dhe Mercedesit tjetër të Bottasit. Finlandezi, shok skuadre dhe rival për titull njëkohësisht, zbret tashmë në 17 pikë diferencë me kampionin. Në vendin e katërt u rendit Verstappen, i cili arriti madje të ngjitej deri në



vendin e dytë, por u detyrua të zbriste dy vende për shkak të një penalizimi. Vendi i dytë i Vettelit ishte një "gjysmëbuzëqeshje" për Ferrarin, pasi piloti tjetër

Leclerc u tërhoq nga gara, në përpjekje për të rikuperuar disa pozicione, pas paraqitjes jo të mirë në kualifikueset e së shtunës.

Besa kampione te meshkujt, Istogu te femrat

PRISHTINË, 26 MAJ - Besa Famgas ka fituar titullin e kampionit të Kosovës në hendboll. Për skuadrën pejane të hendbollistëve është titulli i gjashtë rresht dhe kështu Besa ka vazhduar dominimin në Superligën e Kosovës. Deri të ky sukses, Besa erdhi pasi e fitoi edhe ndeshjen e dytë ndaj Kastriotit në palestrenë

"Bill Clinton" në Ferizaj (26:25). Ndërsa në konkurrencën e femrave, Istogu e ka fituar titullin e parë në histori të klubit, pasi e fitoi ndeshjen e dytë të shtunën në palestrenë "Jeton Tërstena - Tota" ndaj Vushtrrisë (28:26). Istogu javë më parë fitoi edhe Kupën e Kosovës, kurse të meshkujt Kupën e ka rrëmbyer skuadra e Kastriotit.



Dukagjini kontakton Sejdiun

KLINË, 26 MAJ - Skuadra e Dukagjinit nga Klina është anëtare e re e IPKO Superligës së Kosovës në futboll. Kjo

skuadër pas suksesit të madh pritet të bëjë ndryshime edhe në shtabin teknik. Në vend të Ndue Përgjokaj pritet të

emërohet Gani Sejdiu, i cili në disa ndeshje në fund të kampionatit e drejtoi skuadrën e Ballkanit. Gazeta ka mësuar

se bisedimet në mes drejtuesve të skuadrës nga Klina dhe trajnerit Sejdiu tashmë kanë filluar.



Vëllaznimi me premi për ndeshjen e barazhit

GJAKOVË, 26 MAJ - Skuadra e Vëllaznimit i rikthehet barazhit, por kësaj radhe për të gjetur një biletë për Superligë. Skuadra gjakovare është mobilizuar para sfidës

dhe do të bëjë më të mirën për rikthimin në elitë. Kryetari i klubit, Agim Cana, i ka premtuar ekipit një premi prej 50 mijë eurosh në rast të fitores. Lajmi është konfirmuar për

"Olle" nga menaxheri gjeneral Besnik Gojani. "Kryetari ynë, Agim Cana, i ka premtuar skuadrës premi prej 50 mijë eurosh nëse fitojnë ndaj Trepçës '89 në ndeshjen e

barazhit", ka deklaruar Gojani, duke shtuar: "Ne do t'i plotësojmë të gjitha kërkesat e tifozëve, që duan masivisht të jenë pranë skuadrës në ndeshjen e barazhit".



Me sukses u mbajt 'Prishtina Trail Marathon'

Prishtinë, 26 maj - Për herë të parë në Prishtinë është mbajtur Trail Maratona "Prishtina Trail Marathon" e organizuar nga klubi i vrapit "XTrailer fun, run" në bashkëpunim me Federatën e Atletikës së Kosovës. Kjo garë është mbajtur në parkun e Gërmisë në Prishtinë. Gjatë këtij organizimi janë mbajtur garat në 3 disiplina, atë të 10, 21 dhe 42 kilometra. Ndërsa nuk ka munguar edhe organizimi për fëmijë, të cilët vrapuan për rreth një kilometër.

Kushtrim Zebica nga Komiteti Organizativ i kësaj maratone ka pohuar se gjithçka ka shkuar në mënyrën më të mirë të mundshme, duke iu falënderuar vullnetarëve të cilët kanë shprehur dëshirë që t'u ndihmojnë atyre për organizimin e kësaj gare. "Është organizuar gara e parë ndërkombëtare e vrapimit me shtigje malore 'Prishtina Trail Marathon'. Është hera e parë e cila organizohet në Kosovë. Bartës i organizimit të këtij aktiviteti është klubi i 'X-Trailer run, fun'. Këtë iniciativë për organizim e kemi marrë duke u bazuar në bazë të përvojave që i kanë pasur anëtarët tanë me pjesëmarrjen në ngjarje të llojit të tillë në vende të ndryshme evropiane dhe e kemi parë si nevojë dhe mundësi e cila i ka munguar kryeqytetit të Kosovës, po gjithashtu edhe komplet shtetit tonë. Përveç karakterit sportiv, kjo garë e ka një kauzë në vete, është run green, run clean, vrapo gjelbër, vrapo pastër, duke u bazuar se Prishtina ka qenë një nga qytetet e listuara për nga cilësia e ajrit më të dobët në botë", ka deklaruar Zebica, raporton



"KosovaPress".

Një ndër vullnetaret e cila ishte bashkangjitur në organizimin e këtij aktiviteti ishte edhe Leonora Aliu. Ajo kishte vendosur t'i ndihmojë komitetit organizativ për arsye të shumta. Një ndër to ishte edhe arsyeja e këtij organizimi ku, sipas saj, Prishtina duhet të ketë organizime të shumta të këtij lloji. "Po, kam vendosur t'i bashkëngjitem ekipit të vullnetarëve, diku 75 vullnetarë iu kanë bashkuar maratonës të XTrailer Prishtina Marathon. Është maratona e parë që po organizohet në 42 kilometra dhe është maratona e parë që po organizohet në parkun e Gërmisë dhe e cila e ka moton run green, run clean, që i bie të vrapohet pastër dhe për gjelbërimin. Ideja e kësaj maratone është t'i vetëdijesojmë njerëzit rreth aktiviteteve sportive, rëndësinë e mbrojtjes së ambientit dhe duke e pasur parasysh se sa shumë ka nevojë Kosova për një ambient të pasur dhe për pyllëzimin e Kosovës, gjelbërimin e Kosovës kam vendosur që t'i bashkohem kësaj ekipe,

për të dhënë kontributin tim në mes të kësaj shoqërie", ka thënë Aliu.

Në këtë organizim pjesëmarrës ishte edhe Shoqata Down Syndrom Kosova, e cila në këtë organizim promovoi produktet e tyre. Ndërkaq Medina Surdulli ka marrë pjesë në garën për fëmijë. Surdulli u shpreh tejet e lumtur me faktin se ishte pjesë e këtij organizimi dhe para fillimit të garës u shpreh se do të synonte ta fitonte së paku njërin prej tri vendeve të para. "Unë ndjehem shumë e lumtur edhe pse do të marr pjesë në maratonë. Shpresoj se do të fitoj. Shpresoj të marr ndonjë medalje", u shpreh ajo.

Në maratonën 10 kilometra në kategorinë e femrave fituese doli atletja nga Peja, Gresa Bakraqi, e cila pas garës u shpreh tejet e lumtur me faktin se arriti të triumfojë në këtë garë. Kujtomë që në këtë maratonë kanë marrë pjesë garues nga 18 vende të ndryshme të botës dhe organizatorët premtuan se do të vazhdojnë çdo vit të organizojnë një gjë të tillë, por me moto të ndryshme.

SHKURT

Skuadra ruse 'blindon' Roshin

Odise Roshi ka nënshkruar kontratën e re dhe do të mbetet në Rusi tek Ahmet Grozni. Gjithçka ka marrë formë zyrtare teksa klubi çeçen ka njoftuar zgjatjen e bashkëpunimit me fierakun edhe për tre vjet të tjera. Një formë besimi ndaj anësorit, që sezonin e fundit kaloi një dëmtim të rëndë. Sigurisht një kontratë nga e cila do të fitojë edhe të ardhura të rëndësishme. Roshi e ka pranuar propozimin e bërë nga Ahmet Grozni, klub të cilit iu bashkua në vitin 2016. Mesfushori 28-vjeçar numëron 30 ndeshje si titullar, ndërkohë që ka arritur të shënojë edhe dy gola në elitën e futbollit rus. Në të shkuarën Roshi ka luajtur me Flamurtarin, Kolnin, FSV Frankfurti dhe Rijekan.

Bayerni konfirmon Kovaqin edhe për sezonin tjetër

Pas suksesit të Bayern Munchenit në finale të Kupës së Gjermanisë, drejtuesit e klubit bavarez konfirmojnë në detyrë trajnerin Niko Kovac. Presidenti i kampionëve të saposhpallur në Bundesligë, Karl-Heinz Rummenigge, tregoi mbështetje të plotë për trajnerin kroat. "Sigurisht që Niko do të mbetet trajneri ynë, kjo nuk është vënë asnjëherë në diskutim. Ne kurrë nuk kemi kërkuar për trajner të ri. Në fund të fundit, për Bayernin kanë rëndësi trofetë dhe tekniku luan rol të rëndësishëm në arritjen e objektivave", ka thënë Rummenigge.

Barça përgatit 'fshesën'

Barcelona është shpallur kampione e La Ligës, por ka dështuar në Ligën e Kampionëve dhe Kupën e Mbretit. Në këtë klub pritet të bëhen shumë ndryshime gjatë verës, kurse mediet spanjolle kanë zbuluar edhe emrat e disa prej futbollistëve që pritet të largohen. Përveç Malcomit dhe Gomesit, në këtë listë janë edhe Samuel Umtiti dhe Philippe Coutinho. Ndërsa deri tash Barça e ka transferuar vetëm Frenkie de Jong nga Ajaxi për 75 milionë funte.

Balotelli konfirmon largimin nga Marseille

Mario Balotelli ka njoftuar se do të largohet nga skuadra e Marseillet. Ky vendim i sulmuesit vjen vetëm pak ditë pasi është larguar trajneri Rudi Garcia. "Faleminderit të gjithëve për këta pesë muaj magjikë. Edhe pse nuk i arritëm objektivat që kishim vënë, dua ta falënderoj trajnerin, stafin, lojtarët, presidentin dhe klubin. Të gjithë ata që punojnë tek Olimpik Marsejë. Dhe tifozëve... Faleminderit! Shpresoj të rishihemi së shpejti, ose fat në vitet në vazhdim", ka thënë Balotelli.

Milneri: Messi më quajti 'gomar'

James Milner ka zbuluar se Lionel Messi e quajti atë "gomar" në tunelin e stadiumit gjatë ndeshjes së Ligës së Kampionëve kundër Barcelonës. Në pushim, pas pjesës së parë, Messi e takoi mesfushorin anglez dhe e quajti "gomar" teksa ia kujtoi edhe një rast kur e dribloi me topin mes këmbëve. "Ai nuk ishte i lumtur, po më fliste ashpër në spanjisht duke hyrë në tunel pas pjesës së parë. Ai më quajti 'burro'. 'Burro' përkthehet si gomar, por unë mendoj se është përdorur edhe në futbollin spanjoll si një term i përgjithshëm për dikë që të ndërhyt shpesh. E pyeta nëse ai ishte në rregull. Nuk mendoj se ai e dinte se e kuptoja spanjishten e tij. Ai tha: 'Më bëtë faull, për shkak se unë ju futa topin mes këmbëve'. E lash atë në atë pikë dhe shkoi në zhyshetore. Unë kam vetëm admirim për të. Ai ka fituar të drejtën për të thënë atë që do. Gjërat që ai bëri në atë lojë, gjërat që ai e ka bërë gjithë karrierën e tij, e bën atë të vështirë të luash kundër ti", ka thënë Milner.

Toronto shkruan historinë, për herë të parë në finale

TORONTO, 26 MAJ - Për herë të parë në histori, skuadra e Toronto Raptorsit ka siguruar kualifikimin për në finalen e "play-off"-it në NBA, aty ku duke nisur nga data 30 maj do të përballet për titullin kampion ndaj Golden State Warriorsit. Skuadra kanadeze fitoi 100-94 ndaj Milwaukeees në finalen e gjashtë të "play-off"-it në Konferencën e Lindjes, duke marrë trofeun e kësaj konference. Heroi i skuadrës së Torontos është Kawhi Leonard, lideri i këtij ekipi, që tregoi edhe një herë se është një kampion. Në këto finale nuk zhgënjëu, duke qenë gjithnjë e më shumë një ikonë. Leonardo realizoi 27 pikë e 17



rebounde në këtë finale të gjashtë, ndërkohë që vendimtare janë edhe 32 pikët e ardhura nga lojtarët e stolit. Edhe pse Milwaukee e udhëhoqi ndeshjen në shumicën e kohës, madje duke qenë deri në 15 pikë avantazh në periodën e tretë,

nuk arriti të triumfojë. Antetokounmpo zhgënjëu atëherë kur nuk pritej, në këto finale të "play-off"-it në Lindje, duke mos dhënë atë që pritej. Ai ishte shënuesi më i mirë i Bucksit, me 21 pikë e 11 rebounde, por nga ai pritej më shumë. Ditën e enjte, më 30 maj, do t'i nisn finalen "play-off" në NBA, me Toronton që do të ketë faktorin fushë në favorin e saj, pasi ka rezultatin më të mirë se Golden State në sezonin e rregullt. Dy ndeshjet e para do të luhen në fushën e skuadrës kanadeze, që ka kështu mundësinë të vijojë të ëndërojë, për të shkruar diçka të jashtëzakonshme në historinë e NBA-së.



EPOKA E RE						Autor: GAZMEND MORINA	AFTËSIA E NJERIUT PËR TË KRIJUAR	LLOJ ZOGU KËNGËTAR	▼	FORTESË LIMIT	ERA E MIRË	SHTET I MADH NË AZI	EPOKA E RE	BASHKËT.	OLIVER NEUVILLE	FARMACI	PËREMËR PRONOR		
						QË UA MBATH KËMBËVE NGA FRIKA							HATAJA AKTORI MORINA						
						SËMUNDJE E RËNDË QË SHKAKTOHET NGA PARAZITË SHUMË TË VEGJËL (shq.)								ZULMË TËRHEQJE					
						LLOJ GJARPRI									"RISANI" IZET FETAHAJ				
						GJILANI, ARTANA			MBIEMËR CILËSOR	LETRARI CAMAJ ARIANITI (perkdh.)								EMËRIMI NË NJË POZITË	
						AKTORJA CAHANI							EMËR YNI MASHKULLI NANTES						
						DJALI I VAJZËS					"N" para dy "A" KULAÇE (shq.)				"TORINO"				
						PADITËSI I SOKRATIT							DY BASHKËTINGËLLORE "IRLANDA"			OLIVIER MARTINEZ ZANORE			
EPOKA E RE						MANEKINIA SHQIPTARE HITAJ	PËRCAKTIM, PËRKUFIZIM	URANI, KRABONI	SHTET AFRIKAN (pashq.)	PJESËTAR I NJË FISI ILIRI	FORMË E TË HYRAVE SHTETËRORE (shq.) THEMBRA E KËPUCËS			SHTET AZIATIK (pashq.) DËSHIROJNË					
						SJELLJA E NJERËZISHME					ZANORE MJET I THJESHTË PUNE		AKTORI ISLAMI (shq.) ZANORE			ESTONIA, NORVEGJIA KËNGËTAR I NJOHUR AMERIKAN			
						FLETA E VOGËL, KU MJEKU SHËNON LLOJET E BARNAVE					SULM E HAPUR			UNIVERSITY OF AUCKLAND			ZANORE FIGURË E RIPRODHUAR E NJË SENDI, SHËMBËLLTYRË		
						AGIM TEJECI		LLOJ METALI LUTJE DREJTUAR ZOTIT (mysl.)			KËNGËTARJA ITALIANE PAUSINI		UGANDA POLITIKANI FINLANDEZ ... REHN		ANKESË SONDAZHI				
						KËNGËTARJA E NJOHUR SHQIPTARE NË FOTO								ALEN NURI OSAKA		NJËSIA E REZISTENCËS ELEKTRIKE FEMRAT LUFTËTARE (mit. greke)			
						BIMË SHUM-ËVJËÇARE ME TRUNG TË TRASHË			BASHKËT.	KALIBËR I TYTËS SË ARMËS QË VEPRON ME GJALLËRI					SKAJI, QOSHJA ISMET MALAJ			ALBANOLOGIA DURHAM	
						GURRA		AMPER, ALUMIN SHKRETËTIRA MË E THATË NË BOTË			DY ZANORE AUSTRIA, ISLANDA		AKTORJA AMERIKANE BASINGER FUTBOLLISTI FRANCEZ NASRI			ZHAN EDUARDSON DISIPLINË SPORTIVE			
EPOKA E RE						ZANORE I THAJ		BËRË ANKESË ANA VISI					LUMË NË SHQIPËRI TËRËSIA E ORENDIVE					BASHKËT. KËNGËTARJA ANGLEZE TANITA	
						ZEMËRIM				ORGANIZATA MAFIOZE "..... KINEZE" FARISHTA					PERËNDIA				
						QYTET SHQIPTAR NË MAL TË ZI					ANTON PASHKU	KLUB FUTBOLLI ARGJENTINAS "... LORENZO"	SOLISTJA BYTYQI VENDËSI			PEZMATIM I VESHIT U PESHOVA			
						ERMAL MAMAQI		LLOJ MOTOÇIKLETE QË PRODHOHET NË JAPONI AKTORI CRUISE (shq.)							QË S'KA TJETËR TË NGJASHËM ME TË TË LUTEM			ILAÇI	
						BASHKËT.	GOTË PREJ BAKRI KAMION I VOGËL			PEIZAZH I GJERË SPEECH AUSTRALIA PATHOLOGY							ANITA BITRI PËREMËR VETOR		
EPOKA E RE						ISH PRESIDENTI AMERIKAN XHEFERSON NJË E RESHUR					SHEGË TENI ANDERSON			ENË E MADHE PËR TË MBAJTUR QUMËSHT TANTAL					
						POTERË (sh.shq.)										RAST BASHKËT.			
						PËREMËR PRONOR			KAMPIONI, ASI										DEGË E MJEKËSISË



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS
DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME/DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL
SERVICES/DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA
DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/DIVISION OF HUMAN RESOURCES/DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-149, Ligjin Nr. 02/L - 057, për Institucionet e Kulturës, të Ligjit Nr.02/L - 088 për Trashëgiminë Kulturore, Statutin e Muzeut Kombëtar të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 21/2012, për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

KONKURS (Rekrutim i brendshëm)

Titulli i punës: Drejtor
Institucioni: Muzeu Kombëtar i Kosovës
Kategoria funksionale : Koeficienti: 10
Numri i referencës: 25/2019

I përgjigjet: Këshillit Drejtues të MKK

Vendi: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Këshillit Drejtues të Muzeut Kombëtar të Kosovës, përbushë detyrat dhe përgjegjësitë e poshtëshënuara:

- Drejtori është udhëheqës dhe organi më i lartë ekzekutiv i MKK-së;
